



This programme is funded
by the European Union

BALKANS ACT NOW!

Raport mbi Monitorimin e Politikave të Antitrafikimit në Shqipëri (2019)



Ky raport pilot është përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare në kuadër të projektit Balkans ACT Now (Kundër trafikimit) financuar nga Bashkimi Evropian, Instrumenti i Mbështetjes së Para- Anëtarësimit (IPA); Konsolidimi i Rrjetit tematik rajonal të organizatave të shoqërisë civile ; ID: EuropeAid/154870/DH/ACT/Multi; Kontrata Nr: 2017/394-348

Tabela e Përmbajtjes

PJESA E I: SFONDI, QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIT	- 8 -
1. Hyrje	- 8 -
2. Qëllimi dhe objektivat e raportit	- 10 -
3. Përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve	- 11 -
B. Identifikimi i viktimave të trafikimit.....	- 12 -
MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE JETËS PRIVATE TË VIKTIMAVE/ VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT	- 15 -
PJESA E II: REZULTATET E MONITORIMIT TË POLITIKAVE ANTITRAFIK NË SHQIPËRI 2019.....	- 17 -
1. ANALIZA E KUADRIT LIGJOR SHQIPTAR NË FUSHËN E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE: PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE (INDIKATORË AA1-27).	- 17 -
1.1 Sfondi.....	- 17 -
1.2 Koncepti i trafikimit të qenieve njerëzore, mënyrat dhe format e trafikimit të personave.....	- 18 -
1.3 Veprat penale të ndërlidhura me trafikimin e personave	- 20 -
1.4 Masat e dënimit në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe respektimi i standardeve ndërkombëtare.....	- 21 -
1.5 Juridiksioni mbi veprat penale të trafikimit përcaktuar në ligjin penal dhe procedural shqiptar dhe përcaktueshmëria e “trafikimit të qenieve njerëzore” si vepër penale e ekstradueshme	- 23 -
1.6 Mungesa e parashikueshmërisë në legjislacionin shqiptar të dënimit të viktimave të trafikimit si edhe parashikimi për lirimin e tyre nga paraburgimi. (indikator A22-23).....	- 23 -
Rekomandime në drejtim të Indikatorit të Grupit Aa:	- 24 -
2. IDENTIFIKIMI I VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT: GJETJE TË SHTETIT SHQIPTAR.....	- 25 -
Identifikimi i viktimave të trafikimit/ kuadri ligjor dhe rezultatet për 2019.....	- 25 -
Rekomandime në lidhje me identifikimin e VT/VMT:	- 31 -
3. MBROJTJA E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT: GJETJE TË SHTETIT SHQIPTAR GJATË 2019	- 32 -
3.1 Mbrojtja ligjore për viktimat e trafikimit.....	- 32 -
3.2 Rezultatet e monitorimit mbi mbrojtjen e ofruar për VT/VMT (2019).....	- 34 -
3.3 Mbrojtja e fëmijëve – viktimat të trafikimit/viktima të mundshme të trafikimit.....	- 36 -

3.4 Mbrojtja e Viktimave të huaja:	- 37 -
Rekomandime në lidhje me grupin e indikatorëve C.....	- 38 -
4. ASISTENCA DHE MBËSHTJETJA PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT: GJETJE TË SHTETIT SHQIPTAR PËR 2019	- 39 -
4.1 Asistenca në përgjithësi për viktimat e trafikimit	- 39 -
4.2 Asistenca dhe mbështetje për fëmijët viktimë	- 40 -
4.3 Ndihma juridike falas dhe asistenca ligjore	41
4.5 Kompensimi i viktimave të trafikimit, raste praktike	- 43 -
Rasti V.P, kërkimi i dëmit pasuror dhe jo-pasuror në procesin civil	
<i>Gjetje në lidhje me dëmin material e moral të shkaktuar si rezultat i trafikimit dhe shfrytëzimit seksual si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore:</i>	
Problematika të evidentuara gjatë procesit gjyqësor civil të V.P	- 43 -
Çështja e trafikimit, ekzekutimi i vendimit të formës së prerë	- 44 -
Rekomandime në lidhje me grupin e indikatorëve D dhe E:	45
5. KUADRI INSTITUCIONAL, DUKE PËRFSHIRË KAPACITETET, KOORDINIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR.	46
Kuadri institucional, bashkëpunimi dhe koordinimi kombëtar dhe ndërkombëtar.....	47
Rekomandime në lidhje me grupin e indikatorëve F	48
6. MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE JETËS PRIVATE TË VIKTIMAVE/VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT	- 51 -
Rekomandime në lidhje me grupin e indikatorëve G	- 52 -
Bibliografi:.....	- 53 -

Ky raport është përgatitur në kuadrin e projektit: "Balkans Act Now BAN III", i cili financohet nga Komisioni Evropian dhe zbatohet nga QNL. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e QNL dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e Komisionit Evropian."

LISTA E SHKURTIMEVE:

MKR - Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave

KRAT - Komitetet Rajonale Antitrafik

PSV - Procedurat Standarde të Veprimit

NjMF -Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve

AP - Autoriteti Përgjegjës

DASH - Departamenti Amerikan i Shtetit

G/SPIF Grupi/ Struktura Përgjegjëse për Identifikim Formal

OKB Organizata e Kombeve të Bashkuara

KE - Këshilli i Europës

KKSAT - Koalicioni Kombëtar i Strehezave Anti trafik

MB - Ministria e Brendshme

MD - Ministria e Drejtësisë

SHSSH -Shërbimi Social Shtetëror

VT Viktimëtrafikimi

VMT Viktimë e mundshme trafikimi

ZKKAT Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim

QNLQ – Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare

KP – Kodi Penal

KPrP – Kodi i Procedurës Penale

Autor: Dr. Nadia Rusi

PJESA E I: SFONDI, QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIT

1. Hyrje

1. Raporti mbi monitorimin e politikave Anti-Trafik në Shqipëri është përgatitur në kuadër të projektit “*Balkans Act Now*” BAN III implementuar nga organizata ASTRA në bashkëpunim me organizatat partnere në rajon International Solidarity Forum EMMAUS – Bosnje dhe Herzegovine; Women’s Rights Center – Mal i Zi; Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare (CLCI) – Shqipëri; Open Gate La Strada – Maqedoni dhe Komiteti Hollandez i Helsinkit, me mbështetjen e Bashkimit Evropian.
2. Raporti fokusohet në monitorimin e zbatueshmërisë së Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2018–2020¹, legjislacionit dhe politikave kundër trafikimit të qenieve njerëzore nga shteti shqiptar për periudhën Janar – Dhjetor 2019.
3. Ky raport është bazuar në instrumentin/metodologjinë e monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe praktikave kundër trafikimit të qenieve njerëzore të përshtatur për shtetin shqiptar përmes një procesi të gjerë konsultimi me institucionet përgjegjëse në këtë fushë si Zyra e Koordinatorit Anti-Trafik, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Policia, Prokuroria, Organizatat Jo-fitimprurëse që janë aktive në këtë fushë si edhe Qendrat pritëse dhe ri-integruese të viktimave të trafikimit që punojnë në Shqipëri.
4. Raporti hartohet me qëllimin për të krijuar një model raportimi të bazuar në një metodologji monitorimi të ndjekur edhe nga vendet e tjera të rajonit dhe do të shërbejë jo vetëm për të monitoruar politikat anti-trafik në Shqipëri në një vit të caktuar, por gjithashtu, edhe për të krahasuar të dhënat dhe standardet që vendi ynë ka ndjekur në këtë fushë me vendet e tjera të rajonit të përfshira në këtë projekt.
5. Një kontribut të rëndësishëm për hartimin, konsultimin dhe vlefshësin e gjetjeve të këtij raporti kanë dhënë përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme dhe Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Zyra e Përmbarimit, organizatat anëtare të Koalicionit Kombëtar Anti- trafik në Shqipëri ndër të cilat Qendra Psiko -Sociale “Vatra”, Qendra “Të ndryshëm dhe të Barabartë”, “Tjetër Vizion” si edhe qendra “Për Nisma Ligjore dhe Qytetare” të cilat kanë ndjekur dhe konsultuar procesin e monitorimit të nivelit të zbatueshmërisë së indikatorëve, politikave dhe masave anti-trafik si edhe kanë asistuar ndjekjen e rasteve konkrete të VT/VMT me qëllim nxjerrjen e problematikave dhe hartimin e rekomandimeve të vlefshme për këtë raport.
6. Raporti paraqet gjetjet e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të shtetit shqiptar në lidhje me situatën ligjore dhe faktike të identifikimit, ndjekjes dhe mbrojtjes së VT/VMT gjatë periudhës së monitorimit për secilën nga fushat e mëposhtme: a) Kuadri ligjor për penalizimin e trafikimit të personave, b) identifikimi i viktimave të

¹ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 770, datë 26.12.2018 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2018–2020” i aksesueshëm tek <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/VKM-nr.-770-date-26.12.2018-Plani-Kombetar-i-Veprimit-2018-2020-1-1.pdf>

trafikimit, c) mbrojtja e viktimave të trafikimit, d) asistenca dhe mbështetja për viktimat e trafikimit e) kompensimi dhe dëmshpërblimi f) kuadri institucional, koordinimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar si edhe f) rruajtja e të dhënave dhe mbrojtja e jetës private të viktimave të trafikimit/ VMT. Për sa më sipër, indikatorët e metodologjisë së monitorimit që mbulojnë secilën prej këtyre çështjeve u morën në konsideratë për strukturimin e raportit dhe orientimin e punës analitike.

7. Raporti analizon arritjet ligjore dhe politike, boshllëqet dhe sfidat në identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit/VMT sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të ndjekura në këtë fushë. Ai përmban rekomandime në terma të përmbushjes së detyrimeve të qeverisë shqiptare dhe institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor në drejtim të përmirësimit të kornizës ligjore dhe politikave për rritjen e efikasitetit të mekanizmave institucionale për identifikimin e shpejtë të VT/VMT si edhe për mbrojtjen dhe garantimin e aksesit të plotë të VT/VMT të të gjitha kategorive dhe grupeve vulnerabël, të rritur apo fëmijë, vendas apo të huaj në të drejta apo shërbime.
8. Në planin metodologjik, për hartimin e raportit u realizuan disa takime me përfaqësues të institucioneve të ndryshme shtetërore dhe u përdorën intervistat me përfaqësues të këtyre institucioneve (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Prokuroria, Policia) bazuar në pyetjet e përgatitura nga grupi i punës me qëllim mbledhjen e të dhënave brenda fushës së tyre të ekspertizës në institucion. Në të njëjtën kohë, u mblodhën të dhëna si rezultat i analizës dhe studimit të raporteve të shtetit shqiptar në fusha që mbulon nga ky raport. Të dhënat paraprake pjesë e këtij raporti u konsultuan në tryezën teknike të organizuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafik në bashkëpunim me QNL me pjesëmarrjen e përfaqësuesëve të Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Policisë, Zyrës së Përmbarrimit si edhe përfaqësuesve të Koalicionit Anti-trafik në Shqipëri me qëllim diskutimin dhe vleftësimin e tyre. Rezultatet e tryezës së diskutimit dhe rekomandimet e dërguara nga institucionet pjesëmarrëse u reflektuan në draftin përfundimtar të raportit i cili u nda me të gjithë institucionet referuese.
9. Në hartimin e këtij raporti janë mbajtur parasysh edhe raportet vjetore dhe buletinet e vecanta anti-trafik të hartuara nga Ministria e Brendshme në kuadër të monitorimit të zbatimit të planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2018-2020 dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Mbi zbatimin e planit ndër-institucional të veprimit për zbatimin në Shqipëri të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, “Gratë, Paqja dhe Siguria”, 2018– 2020.
10. Po kështu, raporti përfshin edhe analizën e rasteve praktike të ndjekura nga vetë organizatat jo fitimprurëse, anëtare të Koalicionit Kombëtar Anti-Trafik në Shqipëri kryesisht nga qendra “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”, Qendra psiko-sociale “Vatra”, qendra “Tjetër Vizion” si edhe nga veprimtaria e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare”.
11. Për të pasur një tablo më të plotë të situatës reale në drejtim të analizës së progresit dhe evidentimit të çështjeve shqetësuese, raporti është bazuar edhe në të dhënat e publikuara të institucioneve ndërkombëtare që monitorojnë zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare dhe politikave antitrafik në Shqipëri si Raporti i Progresit për Shqipërinë (2020), raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi trafikimin e personave në Shqipëri (2020), Raporti i Tretë i Vlerësimit për Shqipërinë të grupit të ekspertëve mbi masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore GRETA (2020) si edhe raporti i paraqitur nga shteti shqiptar përpara Komitetit CEDAW (2020). Të dhënat e mësipërme kanë shërbyer si burime sekondare të cilat janë marrë në konsideratë në përputhje me fushat e këtij raporti monitorimi.

12. Në të njëjtën kohë, si bazë dhe burim informacioni kanë shërbyer edhe rezultatet e tryezave teknike tematike të QNL të realizuara gjatë periudhës së monitorimit brenda fushave të raportit, si edhe në dhe të dhënat e garantuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT)² dhe vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë .
13. Gjetjet e raportit të monitorimit do të shërbejnë për të krijuar një panoramë të përgjithshme mbi gjendjen e kuadrit rregullator anti-trafik në Shqipëri gjatë 2019 dhe sidomos në lidhje me zbatueshmërinë e këtij kuadri nga të gjithë aktorët shtetërorë të përfshirë në procesin e identifikimit të viktimave të trafikimit, trajtimin e rasteve të trafikimit dhe garantimin e mbrojtjes së të drejtave të këtyre viktimave në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, rezultatet e këtij raporti dhe sidomos hapësirat dhe boshllëqet që ai do të nxjerrë mbi politikat antitrafik në Shqipëri do të shërbejnë si pikënisje për përmirësimin jo vetëm të kuadrit ligjor dhe nënligjor, por edhe të përmirësimit të sistemit të ndërhyrjes dhe bashkëveprimit të të gjitha insitucioneve ligjzbatuese në Shqipëri në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

2. Qëllimi dhe objektivat e raportit

14. Ky Raport do të hedhë dritë mbi rezultatet që kanë dalë nga monitorimi i zbatueshmërisë së Planit Kombëtar të Veprimit Anti-trafik 2018-2020 bazuar në instrumentin e monitorimit. Objektivi kryesor i këtij raporti është të vlerësojë gjendjen e shtetit Shqiptar mbi kuadrin ligjor kombëtar në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, të masë përputhshmërinë e këtij kuadri ligjor me standardet dhe politikat ndërkombëtare, të eksplorojë nivelin e zbatimit të ligjit dhe politikave anti-trafik nga institucionet referuese në ligj, të identifikojë nivelin e arritjeve si edhe të ngrejë çështjet më problematike të kësaj fushë në drejtim të strukturave shtetërore kombëtare. Në mënyrë të përmbledhur si objektiva të raportit të monitorimit mund të përmendim:
- *Të vlerësojë efektivitetin e kuadrit ligjor shqiptar në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore*
 - *Të eksplorojë nivelin e progresit dhe/ose ndryshimeve të bëra nga shteti shqiptar në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore ;*
 - *Të eksplorojë nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimin institucional me qëllim identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore;*
 - *Të identifikojë problemet dhe hapësirat ligjore/politike në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore si edhe çështjet teknike që duhet të rregullohen në të ardhmen;*
 - *Të vlerësojë cilësinë e të dhënave të mbledhura bazuar në indikatorët e monitorimit, të identifikojë indikatorët ku mungojnë të dhënat dhe të dalë me rekomandime mbi përmirësimin e sistemit të të dhënave në fushën e trafikimit dhe/ose zgjerim të fushës së të dhënave me qëllim bërjen të mundur të një procesi më të gjerë monitorimi në vitet në vazhdim;*
 - *Të ofrojë rekomandime konkrete mbi përmirësimin e kornizës ligjore, bashkëpunimin institucional dhe politikat në fushën e trafikimit;*
15. Raporti është hartuar gjithashtu me synimin për të krijuar një model raportimi që mund të ndiqet në të ardhmen nga Ministria e Brendshme dhe një sistem krahasimi të dhënash në fushën e politikave anti-trafik midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit të përfshira në projekt. Duke pasur një pasqyrë reale monitorimi të zbatimit të politikave shtetërore, bazuar në indikatorët kombëtare anti-trafik, si dhe duke prezantuar të dhënat e nxjerra nga monitorimi në rastin e Shqipërisë, do të mund të

² INSTAT është institucioni kryesor përgjegjës për prodhimin e statistikave zyrtare në Shqipëri.

jemi të aftë t'i krahasojmë ato me rezultatet e nxjerra nga vendet e tjera të rajonit, me qëllim jo vetëm për të parë vendin që shteti shqiptar ka brenda rajonit në lidhje me zbatimin e politikave anti-trafik, por sidomos për të krijuar një sistem koordinimi me këto vende, për të përthithur shembujt më pozitive të rajonit dhe t'i inkudrojmë ato në sistemin tonë si edhe të ofrojmë eksperiencën tonë në lidhje me ato raste ku ne mund të shërbejmë si një shembull pozitiv për vendet e tjera të rajonit.

16. Për sa më sipër mund të themi se gjetjet e këtij raporti do t'i shërbejnë së pari Ministrisë së Brendshme dhe Zyrës së Koordinatorit Anti-Trafik si edhe në një plan më të gjerë aktorëve shtetërorë të përfshirë në sistemin e identifikimit dhe trajtimit të rasteve të trafikimit, organizatave jo-fitimprurëse në Shqipëri që janë aktive në fushën e anti-trafikimit, organizatave rajonale/ndërkombëtare aktive që punojnë për të njëjtin qëllim si edhe çdo personi të interesuar në kuadrin ligjor kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe zbatimin e tij.

3. Përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve

3.1 Raporti mbi monitorimin e politikave Anti-Trafik në Shqipëri fokusohet në monitorimin e zbatueshmërisë së legjislacionit dhe politikave kundër trafikimit të qenieve njerëzore nga shteti shqiptar për periudhën Janar – Dhjetor 2019 bazuar në instrumentin/metodologjinë e monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe praktikave kundër trafikimit të qenieve njerëzore të përshtatur për shtetin shqiptar.

3.2 Raporti paraqet gjetjet e procesit të monitorimit dhe vlerësimit në lidhje me situatën ligjore dhe faktike të identifikimit, ndjekjes dhe mbrojtjes së VT/VMT gjatë periudhës së monitorimit për secilën nga fushat e mëposhtme: a) Kuadri ligjor për penalizimin e trafikimit të personave, b) identifikimi i viktimave të trafikimit, c) mbrojtja e viktimave të trafikimit, d) asistencë dhe mbështetja për viktimat e trafikimit e) kompensimi dhe dëmshpërblimi f) kuadri institucional, koordinimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar si edhe f) ruajtja e të dhënave dhe mbrojtja e jetës private të viktimave të trafikimit/ VMT.

3.3 Raporti analizon arritjet ligjore dhe politike, boshllëqet dhe sfidat në identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit/VMT sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të ndjekura në këtë fushë. Ai përmban rekomandime në terma të përmbushjes së detyrimeve të qeverisë shqiptare dhe institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor në drejtim të përmirësimit të kornizës ligjore dhe politikave për rritjen e efikasitetit të mekanizmave institucionale për identifikimin e shpejtë të VT/VMT si edhe për mbrojtjen dhe garantimin e aksesit të plotë të VT/VMT të të gjitha kategorive dhe grupeve vulnerabël, të rritur apo fëmijë, vendas apo të huaj në të drejta apo shërbime.

A. Analiza e kuadrit ligjor shqiptar në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore:

Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare

1. Kuadri ligjor kombëtar në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore **përgjithësisht reflekton standardet ndërkombëtare**. Ndryshimet e viteve të fundit në kuadër të reformës në drejtësi e kanë përmirësuar kornizën ligjore anti-trafik, duke e orientuar garantimin e parandalimit, mbrojtjes dhe ndjekjes së rasteve të trafikimit kryesisht tek sfidat institucionale për zbatimin adekuat të kuadrit ligjor. Megjithatë, ekzistenca e dispozitave të veçanta të ligjeve të ndryshme në fushën e trafikimit të qenieve

njerëzore, evidentuan mungesën e **një ligji kuadër të posaçëm në kuadër të mbrojtjes së viktimave të trafikimit**, i cili mund të bashkonte dhe koordinonte më mirë të gjitha ligjet në fushën e trafikimit të qënieve njerëzore.

2. Gjithashtu, në ndryshim nga dispozitat e Konventës së Palermos dhe përkufizimet ndërkombëtare të cilat në nocionin “trafikim i qënieve njerëzore” përfshijnë si të rriturit ashtu edhe fëmijët, në rastin e Kodit Penal shqiptar ekzistojnë dy nene të vecanta (110/a dhe 128/b) të cilat në thelb ndryshojnë vetëm në lidhje me subjektin që preket, pra nëse është i rritur apo fëmijë.
3. Mungesa e një neni të posaçëm mbi trafikimin e qënieve njerëzore ka sjellë edhe probleme të tjera të kuadrit ligjor. Kështu, lidhur me trafikimin e të rriturve nuk është parashikuar *shprehimisht mungesa e rëndësisë së pëlqimit në kryerjen e veprës së trafikimit*. Ndërkohë, tek dispozitat mbi trafikimin e fëmijëve nuk parashikohet dënimi i “*trafikimit të brendshëm*”.
4. **Në drejtim të kuadrit ligjor që mundëson gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve që rrjedhin nga krimet e lidhura me trafikimin e personave me rëndësi vlen të përmenden ndryshimet e miratuara me ligjin Nr.85/2020 në ligjin nr.10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.** Ndryshimet që solli ky ligj plotësuan kornizën ligjore për konfiskimin e produkteve të krimit. Megjithatë, evidentohet ende si boshllëk mungesa e një kuadri ligjor që synon pasurinë e pajustificuar.
5. Masat e dënimit të parashikuara për veprat e trafikimit të qënieve njerëzore janë pothuajse të harmonizuara me kuadrin ndërkombëtar. Megjithatë, problem mbetet rishikimi i kuadrit ligjor penal në drejtim të përfshirjes në *ligjin penal të konceptit të ndalimit të ndëshkimit të viktimës së trafikimit*.

B. Identifikimi i viktimave të trafikimit

1. Procedurat për identifikimin e viktimave të trafikimit në Shqipëri (VKM nr.499/2018) **janë hartuar në të njëjtën frymë me instrumentet ndërkombëtare** që trajtojnë çështjet e parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të personave dhe reflektojnë rekomandimet e dhëna për të njëjtën fushë veprimi nga organizma ndërkombëtare.
2. Megjithatë, mbetet ende punë në drejtim të harmonizimit të konceptit të VMT me aktet ndërkombëtare dhe përfshirja në PSV të nocionit të Viktimës së Prezumuar të Trafikimit si zëvendësim të VMT me qëllim shmangien e interpretimit të gabuar në rast të bashkëpunimit ndërkombëtar.
3. Për vitin 2019, mbi 90% e viktimave të identifikuara janë shtetase shqiptare dhe mbi 65% janë fëmijë. Pothuajse 78% e VTM/VT janë të seksit femër. I njëjti trend në përqindje vazhdon të rruhet edhe për vitin 2020, megjithë numrin më të ulët të viktimave të identifikuara (65). Identifikimi i viktimave të trafikimit është bërë në pjesën më të madhe nga institucionet shtetërore të përfshira në identifikimin e VT/VMT dhe njësitë lëvizëse në përbërje të të cilave ka edhe një përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe një punonjës të mbrojtjes së fëmijëve.
4. Referuar identifikimit të viktimave të grupeve të ndryshme sociale, nevojitet ende punë për forcimin e **kapaciteteve të inspektoratit shtetëror të punës në lidhje me identifikimin e viktimave të punës së detyruar** dhe identifikimin e rasteve të

detyrimit për lypje kryesisht midis fëmijëve të pashoqëruar, fëmijëve të rrugës apo fëmijëve që kalojnë kufijtë për lypje. Ndërkohë që, lidhur me identifikimin e VMT/VT në rrugët migratore, strukturat e policisë kufitare tashmë janë të trajnuara dhe kanë informacionin e duhur mbi identifikimin e migrantëve VMT dhe përpos kësaj informojnë mbi të drejtat dhe shërbimet që u ofrohen sipas legjislacionit në fuqi. Vetëm në 2019 kemi pasur 2 raste VMT të identifikuara si azilkërkuese.

5. Në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale, mbletet problem kufizimi/ndalimi i ndjekjes penale nga prokuroria për shkak të presionit të familjarëve apo ngurrimit të vetë viktimës. Akoma më problematike është rasti kur viktimat e trafikimit detyrohen të ndryshojnë deklaratën në prokurori apo gjykatë duke mohuar shfrytëzimin e tyre për shkak të intimidimit, kërcënimit nga trafikantët, të afërm të tyre apo vetë avokatët e trafikantëve.

C. Mbrojtja e viktimave të trafikimit

1. Kuadri ligjor shqiptar, në lidhje me garantimin e masave mbrojtëse për VT/VMT është hartuar mbi bazën e standardeve minimale mbrojtëse të parashikuara në Nenin 12 të Konventës së KE. Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale të vitit 2017, parashikuan **një pozitë të re të viktimës në procesin penal. Pas ndryshimeve, viktima e veprës penale është palë në procesin penal dhe ka të drejta procedurale që i japin asaj një rol aktiv në këtë proces.**
2. Krahas të drejtave që parashikohen rishtazi për viktimat e veprës penale në përgjithësi, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë edhe të drejta të parashikuara posaçërisht për to. Viktima ka të drejtë kërkojë ndjekjen penale, ndihmë psikologjike, të drejtën për të marrë këshillim dhe shërbim ligjor falas, të këshillohet në gjuhën që ajo e kupton, të zgjedhë mbrojtësin, të kërkojnë kohë për gjendjen e procedimit, të informohet për lirimin e trafikantit.
3. Me shumë rëndësi është sanksionimi në ligj i të drejtës së viktimave të trafikimit për t'u përjashtuar nga shpenzimet gjyqësore dhe e drejta e viktimave për t'u kompensuar dhe dëmshpërblyer. Megjithatë problem i evidentuar mbetet zbatimi i këtyre dispozitave. Deri në 2020 vetëm tre raste të VT/VMT kanë kërkuar, me ndihmën e OJF, të drejtën për t'u dëmshpërblyer. Përcaktimi i pagesës paraprake në vlerën 1% mbetet shqetësuese në rastin e ushtrimit të kësaj të drejte. Për më tepër edhe në rast të fitimit të së drejtës së viktimave në rrugë gjyqësore, problem i evidentuar ka qënë mungesa e ekzekutimit të vendimit, gjë që ka çuar në mungesën e marrjes së dëmshpërblimit faktik nga ana e viktimës.
4. Në lidhje me të drejtat shëndetësore, legjislacioni në fushën e kujdesit shëndetësor garanton gjithashtu mbulimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor për viktimat e trafikimit. **Ajo që vihet re është mungesa e parashikimit të të njëjtës së drejtë për viktimat e mundshme të trafikimit.**³ Megjithatë, në praktikë, nëpërmjet Autoritetit Përgjegjës në mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është lehtësuar vazhdimisht procesi i pajisjes me kartë shëndeti dhe ndjekja

³Shih Ligji 141/2014 datë 23.10.2014 për amendime të ligjit nr 10383 datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".

nga mjeku familjes respektive për të gjithë VT/VMT, pa dallim të statusit. Gjithashtu, ligji iu mundëson viktimave të trafikimit të drejtën për ndihmë ekonomike. Megjithatë, ndihma ekonomike në shumën 3000 lek në muaj konsiderohet një shumë e pamjaftueshme që nuk mbulon as nevojat jetike të viktimave të trafikimit.

5. Në drejtim të kategorive vulnerabël, problematikë shqetësuese e pandryshuar vazhdon të mbetet mungesa e shërbimeve për viktimat e trafikimit me probleme të shëndetit mendor. Qendrat që ofrojnë shërbime për VT/VMT **nuk kanë në stafin e tyre mjek psikiatër 24 orë ose part time, gjë që ka sjellë refuzimin e hospitalizimit të personave me probleme të shëndetit mendor. Nevojitet në këtë drejtim krijimi i një** qendre specifike për këto kategori dhe fuqizimi real financiar i familjeve të viktimave me probleme të shëndetit mendor me qëllim që ato të kujdesen për fëmijët e tyre.

D. Asistenca dhe mbështjettja për viktimat e trafikimit

1. Mbështetja/asistenca e viktimave të trafikimit mbulohet kryesisht me fondet e Buxhetit të Shtetit. Për vitin 2019 u lëvrua fondi prej 28.320.466 milionë lekësh nga buxheti i shtetit për punonjësit socialë që ofrojnë shërbime në qendra rezidenciale dhe për fond ushqimesh për rastet e trafikuar. Për të gjitha VT/VMT të identifikuar dhe të referuara për shërbime gjatë periudhës së monitorimit është ofruar një paketë e plotë shërbimesh nga strehëzat e KKSAT në bashkëpunim edhe me institucione të tjera si edhe bazuar në vlerësimin e nevojave. Nga të dhënat e marra nga strehëzat që ofrojnë shërbime për VT/VMT, rezulton se, ka pasur raste kur viktimave iu është ofruar strehim alternativ për shkak të nevojave specifike.
2. Raporti tregoi se fëmijët e identifikuar si VT/VMT kërkojnë një angazhim akoma më të madh nga ana e shtetit shqiptar nisur nga statusi me vulnerabël që ata kanë brenda kuadrit të VT/VMT. Nga momenti i identifikimit koha mesatare që një fëmijë e supozuar VT të merrte strehim dhe ndihma të tjera ishte 1-2 ditë. Fëmijët e identifikuar si viktima strehohen dhe marrin ndihmë financiare në qendrat e specializuara antitrafik. Gjithashtu, ato përfitojnë shërbime të përshtatshme për moshën.
3. Referuar asistencës dhe ndihmës juridike vlen të përmendet, iniciativa ligjore e ndërmarrë nga MD në vitin 2017, për të bërë disa ndryshime në ligjin organik që rregullon sistemin e ndihmës juridike falas. Ligji ekzistues nr.10039/2008, u shfuqizua duke passjellë hyrjen në fuqi të ligjit nr.111/2017, i cili solli një sistem të ri të ndihmës juridike falas. Referuar ndryshimeve, VT/VMT kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë juridike falas në formën e ndihmës juridike parësore, ndihmës juridike dytësore, si dhe nëpërmjet përjashtimit nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas ligjit, dhe përjashtim nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit.
4. Megjithatë, në aspektin praktik, gjatë vitit 2019 nuk ka pasur asnjë VT/VMT që ka përfituar ndihmë juridike falas parësore apo dytësore. Ndërkohë që nga të dhënat e vitit 2020 rezulton se 33 raste të VT/VMT kanë përfituar ndihmë juridike parësore falas nga OJF e autorizuar nga MD për këtë qëllim . Ndërkohë që nga 146 çështje të

regjistruara pranë kësaj drejtorie në lidhje me përfitimin nga ndihma juridike dytësore, asnjë rast nuk i përket VT/VMT.

F. Kuadri institucional, duke përfshirë kapacitetet, koordinimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

1. Kuadri institucional në fushën e politikave antitrafik si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal është i kompletuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe funksional. Ai drejtohet nga Koordinatori Kombëtar Antitrafik. Në Ministrinë e Brendshme është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Antitrafikut dhe Azilit si strukturë e posaçme që ushtron kompetenca në zbatimin dhe monitorimin e politikave anti trafik në Shqipëri. Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikimit të Personave është ngritur dhe funksionon nga 2002. Në nivel vendor, janë ngritur dhe funksionojnë komitetet Rajonale të luftës kundër trafikimit të personave në çdo qark.

2. Gjithashtu, në nivel qendror është funksional Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik. Në nivel të bashkëpunimit ndërkombëtar, qeveria shqiptare ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe protokolle shtesë për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore me vendet e tjera.

3. Gjatë periudhës së monitoruar, shteti shqiptar ka rritur kapacitetet e tij në lidhje me kryerjen e hetimeve të përbashkëta të veprave antitrafik në bashkëpunim me shtetet e tjera. Gjatë 2019, policia e shtetit shqiptar ka arrestuar 12 trafikantë me kërkesë të autoriteteve franceze, gjermane, greke dhe italiane . Po kështu gjatë të njëjtës periudhë qeveria shqiptare ka pritur 4 ekstradime të personave të dyshuar për përfshirje në trafikimin e personave nga Gjermania, Greqia, Italia dhe Holanda. Në të njëjtën kohë, autoritetet shqiptare kanë vazhduar hetimet e përbashkëta me autoritetet italiane. Me rëndësi në këtë drejtim mbetet rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim shkëmbimin e informacioneve në lidhje me veprimtarinë kriminale të ushtruar në vendet e destinacionit ku shtetasit shqiptarë janë të dëmtuar apo subjekte të veprës penale.

G. Mbrojtja e të dhënave dhe jetës private të viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit

1. Ekziston një kuadër i gjerë normativ ligjor dhe nënligjor për garantimin e të drejtës së jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave të tyre personale në praktikë. VKM nr .499 datë 29.08.2019 “*Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit*” është hartuar në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale. Mbrojtja e të dhënave dhe jetës private të viktimave të mitur/a bëhet në përputhje me parashikimet e Kodit Për Drejtësinë Penale për të Miturit.

2. Në nivel institucional, në Shqipëri është ngritur dhe funksionon autoriteti kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale të VT/VMT në cilësinë e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në të njëjtën kohë, është ngritur dhe funksionon baza e të dhënave për viktimat e trafikimit SIVET, si pjesë e bazës së të dhënave

të integruara në sistemin TIMS, i cili është i vetmi burim zyrtar për statistikën në lidhje me viktimat/ viktimat e mundshme të trafikimit. Baza e të dhënave të VT/VMT menaxhohet nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik dhe operon në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Megjithatë, pavarësisht ekzistencës së kuadrit ligjor në fuqi dhe mundësisë për fillimin e ndjekjes penale në rast të publikimit të informacionit që çon në identifikimin e viktimave të trafikimit nga mediat apo të tjerët, edhe gjatë periudhës që mbulon ky raport vazhdon të ngrihet shqetësim nga OJF publikimi në media i rasteve të VT/VMT duke zbuluar figurën dhe / ose identitetin e tyre, gjë që sjell rritjen e rrezikut për vazhdimin e jetës normale, mbrojtjen e shëndetit dhe jetës dhe integritetin e VT/VMT në shoqëri.

PJESA E II: REZULTATET E MONITORIMIT TË POLITIKAVE ANTITRAFIK NË SHQIPËRI 2019

1. ANALIZA E KUADRIT LIGJOR SHQIPTAR NË FUSHËN E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE: PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE (INDIKATORË AA1-27).

1.1 Sfondi

1.11 Kjo pjesë e raportit ka në fokus të saj analizën e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar dhe kuadrit strategjik në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore me aktet e tjera me karakter ndërkombëtar dhe evropiane të nxjerra për këtë qëllim.

1.12 Konkretisht, analiza e kuadrit ligjor shqiptar është bërë në drejtim të nivelit të përputhshmërisë së tij me:

- Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Protokolli i Palermos së bashku me dy protokollat pjesë të tij :
 - Protokolli Kundër Kontrabandimit të Migrantëve në Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare dhe
 - Protokolli mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, vecanërisht të Grave dhe Fëmijëve.⁴
- Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Konventa e Varshavës.⁵

1.13 Kuadri ligjor i analizuar kufizohet tek niveli i përfshirjes së standardeve ndërkombëtare të sanksionuara në konventat e sipërcituara si pjesë e:

- Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë⁶
- Kodit të Procedurës Penale në Republikën e Shqipërisë⁷
- Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur
- Ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social
- Ligjit Nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 “Për marrjen e masave ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare
- Ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”
- Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër Trafikimit të personave 2018-2020⁸.

1.14 Çështjet që rregullojnë parashikueshmërinë e “**trafikimit të personave**” si vepër penale, format dhe mënyrat e dënimit të saj gjejnë rregullim përkatësisht në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë⁹ dhe Kodin e Procedurës Penale në Republikën e

⁴Ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin Nr.8920 datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protolleve shtesë të saj.

⁵Ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin Nr.9642 datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”.

⁶Miratur me ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 (i përditësuar 2017)

⁷Miratur me ligjin Nr.7905, datë 21.03.1995 (i përditësuar 2017)

⁸Miratur me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.770 datë 26.12.2018.

⁹Miratur me ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 (i përditësuar 2017)

Shqipërisë¹⁰. Të dy kodet e mësipërme janë përditësuar së fundmi në vitin 2017 në kuadër të Reformës në sistemin e Drejtësisë në Shqipëri.

- 1.15 Ajo që shihet në fakt në planin e përgjithshëm legjislativ është fakti se pavarësisht ndryshimeve që janë bërë në secilin prej ligjeve të mësipërme, ende nuk kemi arritur në **marrjen e një iniciative ligjore** nga Këshilli i Ministrave apo deputetët e Parlamentit shqiptar **për hartimin e një ligji kuadër të posaçëm në kuadër të mbrojtjes së viktimave të trafikimit**,¹¹ i cili mund të bashkonte dhe koordinonte më mirë të gjitha ligjet e sipërpërmendura në fushën e trafikimit të qënieve njerëzore.
- 1.16 Megjithatë, pavarësisht mungesës së një ligji të posaçëm, mund të themi se kuadri ligjor kombëtar në fushën e trafikimit të qënieve njerëzore **përgjithësisht reflekton standardet ndërkombëtare**. Ndryshimet e viteve të fundit e kanë përmirësuar më së miri kornizën ligjore anti-trafik, duke e orientuar garantimin e parandalimit, mbrojtjes dhe ndjekjes së rasteve të trafikimit kryesisht tek sfidat institucionale për zbatimin adekuat të kuadrit ligjor.

1.2 Koncepti i trafikimit të qënieve njerëzore, mënyrat dhe format e trafikimit të personave ¹²

1.21 Konventa e Këshillit të Evropës “Për Masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore” parashikon si koncept të trafikimit të personave “*rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose marrjen e personave për qëllim shfrytëzimi*”.¹³ Në kuptimin e kësaj Konvente shfrytëzimi duhet të përfshijë minimalisht *shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë ose heqjen e organeve*.

1.22 Në referim të përfshirjes së këtij koncepti në legjislacionin penal shqiptar, **Neni 110/a** i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (KP) parashikon si vepër penale “*Trafikimin e personave të rritur*”. Ndërkohë, **Neni 128/b** i kodit penal sanksionon si vepër penale “*Trafikimin e fëmijëve*”.

1.23 Vepra penale e trafikimit të personave parashikuar nga Neni 110/a i KP është pjesë e Seksionit VII të KP me objekt veprat penale **kundër lirisë së personave**. Si e tillë, ajo dallohet nga veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore të parashikuara në nenet 297KP dhe 298 KP që sanksionojnë shprehimisht “*Kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror*” dhe “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*”¹⁴. Gjithashtu krimi i trafikimit të personave dallohet edhe nga krimet kundër autoritetit të shtetit apo veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike. Të njëjtën gjë konkludojmë edhe në lidhje me dallimin midis veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit ku përfshihet sanksionimi i veprës penale të prostitucionit (Neni 113KP) apo shfrytëzimi i prostitucionit (neni 114KP). Në secilin prej rasteve për klasifikimin e shfrytëzimit të prostitucionit si pjesë e trafikimit të personave do të duhet të verifikoheshin format e trafikimit sipas përkufizimit të tij.¹⁵

¹⁰Miratur me ligjin Nr.7905, datë 21.03.1995 (i përditësuar 2017)

¹¹ Shih gjithashtu studimin e bërë nga “Të ndryshëm dhe të Barabartë” “Për nevojën e hartimit të një ligji të vecantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit” (2019)

¹²Shih indikatorë A2/3

¹³Neni 4a i Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore”.

¹⁴ Indikator A.13

¹⁵Indikator A.13

1.24 Analiza krahasimore midis dispozitave kombëtare dhe konventave ndërkombëtare tregon se:

- **Dispozitat kombëtare në lidhje me “mjetet e trafikimit”** janë plotësisht në linjën e Nenin 4/a të Konventës të KE.^{16 17}

- Po kështu, Neni 128/b KP dënon veprën e trafikimit të fëmijëve **në të gjitha rastet**, pa përmendur asnjë nga mjetet e trafikimit që gjenden në dispozitën e trafikimit të personave të rritur, duke reflektuar në këtë mënyrë frymën e direktivës 2011/66 sipas të cilës *“kur trafikimi përfshin një fëmijë atëherë ai duhet të jetë gjithmonë i dënueshëm edhe në rast se asnjë nga mjetet e trafikimit nuk është përdorur.”*¹⁸

- Në përkufizimin që ligji penal i ka dhënë trafikimit të personave të rritur ende **nuk përmbahet në mënyrë të shprehur mungesa e rëndësisë** së dhënies së pëlqimit për efekt të klasifikimit ose jo si vepër penale, detyrim ky i parashikuar në konventën e OKB.¹⁹

- Gjithashtu në lidhje me përkufizimet e të dyja dispozitave mbi trafikimin e qenieve njerëzore (Neni 110/a dhe 128/b) vlen të nënvizojmë faktin se ndërsa në rastin e të rriturve parashikohet në mënyrë të shprehur si trafikimi i jashtëm ashtu edhe i brendshëm, në rasin e **trafikimit të fëmijëve, mungon parashikueshmëria e dënimit të trafikimit të brendshëm.**

1.26 Përkufizimet ndërkombëtare nuk bëjnë ndonjë dallim midis trafikimit të të rriturve apo fëmijëve si në rastin e Kodit Penal shqiptar në të cilin ekzistojnë dy nene të vecanta (110/a dhe 128/b) të cilat në thelb ndryshojnë vetëm në lidhje me subjektin që preket, pra nëse është i rritur apo fëmijë. Në të kundërt, Konventa e Palermos referon si term “trafikimin e qenieve njerëzore” në të cilin përfshihen si të rriturit edhe fëmijët. Duke qënë se koncepti i trafikimit është i njëjtë pavarësisht subjektit të prekur si edhe për të shmangur ndërhyrjet e shumëfishta në dispozitat e kodit tonë penal dhe paqartësitë në përmbajtjen e dispozitave të përsëritura do të ishte me rëndësi përfundimi i procesit të iniciuar nga Ministria e Brendshme/ Drejtësisë lidhur me **ndryshimin e neneve 128/b dhe 110/a, të Kodit Penal, mbi trafikimin e personave, për të përfshirë në një nen të vetëm trafikimin e të dyja kategorive (të rriturve dhe të miturve)** duke reflektuar në këtë mënyrë edhe ndryshimet e nevojshme për sanksionimin e trafikimit të brendshëm të fëmijëve. **Në përputhje me Konventën e Palermos kryerja e veprës penale të trafikimit të personave ndaj të miturve/fëmijëve do të konsiderohej si rrethanë rënduese e cila do të mund të pasohej me aplikimin e sanksioneve më të rënda në këtë rast.**

1.27 Vëmendje duhet t’i kushtohet edhe sferës së kufizuar e gjendjes së vulnerabilitetit të viktimave të trafikimit të parashikuar në Nenin 110/a të kodit penal krahasur me konceptin “pozicion i pambrojtur” të sanksionuar në Direktivën 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit miratuar me 5 Prill 2011 “Mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrotjes së viktimave të trafikimit”. Në vend të termit *“pozicion i pambrojtur”* ligjvënësi shqiptar përdorur termin *“gjendje shoqërore, fizike apo psikike” (neni 110/a)*. Në kuptim të Direktivës 2011/36/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit pozicioni i vulnerabilitetit nënkupton situatën në të cilën personi përkatës nuk ka asnjë alternativë reale, ose të pranueshme, përveçse t’i

¹⁶Neni 4a i Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

¹⁷ Indikator A.3

¹⁸ Indikator A.16

¹⁹ Indikator A15.

nënshtrahet abuzimit.²⁰ Në kontekstin e kësaj direktive veçanërisht koncepti i personave të pambrojtur duhet të përfshijë fëmijët, por gjithashtu mund të merren parasysh edhe gjendje të tjera të lidhura me statusin e viktimës si gjinia, shtatzënia, gjendja shëndetësore apo paaftësia.²¹ *Përfshirja e këtyre gjendjeve në përkufizimin e ofruar nga neni 110/a i Kodit penal do të reflektojë edhe qëllimin e ligjvënësit shqiptar në lidhje me përcaktimin e dënimeve më të larta penale nëse trafikimi kryhet përshembull ndaj grave (Neni 110/a/paragrafi 2) apo fëmijëve (neni 128/b).*

1.3 Veprat penale të ndërlidhura me trafikimin e personave

1.31 Përveç trafikimit të personave, kuadri ligjor shqiptar parashikon edhe vepra të tjera të ndërlidhura me të.²² Kjo qasje reflekton në mënyrë të posaçme përputhshmërinë e legjislacionit kombëtar me Direktivën e BE kundër Trafikimit (Direktiva 2011/36/BE) e cila duke marrë parasysh zhvillimet e fundit në fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore përfshin një koncept më të zgjeruar të asaj që duhet të konsiderohet trafikim në qëniet njerëzore si : skllavëria, puna e detyruar, detyrimi i personave për të lypur, shfrytëzimi seksual, trafikimi i personave me qëllim heqjen e organeve si edhe forma të tjera si aborti i detyruar apo martesë e detyruar në rastin kur ato plotësojnë elementët e veprës penale të trafikimit të personave.²³ Secila prej këtyre veprave të ndërlidhura gjen parashikim të shprehur në Kodin Penal. ²⁴Po kështu, në KP është parashikuar shprehimisht si vepër penale “Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar” (Neni 110/b) dhe “Veprimet që lehtësojnë trafikimin”(Neni 110/c).²⁵

1.32 Megjithatë, si vepra të tjera të ndërlidhura me trafikimin e personave, Konventa parashikon edhe veprat penale për shfrytëzimin e rëndë ekonomik të të rriturve si edhe për shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve nën moshën 18 vjeç.²⁶ Në se analizojmë dispozitat ligjore të Kodit Penal në lidhje me këto dy vepra vëmë re se, ndërsa në rastin e fëmijëve KP e ka të parashikuar një dispozitë të veçantë (krahas asaj të trafikimit të fëmijëve), Neni 124/b “Keqtrajtimi i të miturit²⁷”, në rastin e të rriturve shfrytëzimi ekonomik përfshihet brenda kuptimit të trafikimit të personave të rritur, duke mos pasur një dispozitë të veçantë në lidhje me detyrimin e borxhit. Për më tepër, edhe në rastin e dispozitës mbi trafikimin e personave (Neni 110/a) të KP nuk parashikohet forma e “rëndë” e shfrytëzimit ekonomik.

1.33 Referuar kuadrit ligjor që mundëson gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve që rrjedhin nga krimet e lidhura me trafikimin e personave vlen të përmenden ndryshimet e miratuara me ligjin Nr.85/2020 në ligjin nr.10

²⁰Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit miratuar me 5 Prill 2011 “Mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit” Neni 2/2 .

²¹ Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit miratuar me 5 Prill 2011 “Mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit” paragrafi 12/ preambula.

²²Shih indikatorët A5 – A10

²³Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit miratuar me 5 Prill 2011 “Mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit” paragrafi 11/ preambula.

²⁴Shih Kodi Penal nenet:110/a, 128/b, 114,114/2,117,130.

²⁵Indikator A17/18.

²⁶Indikator A 11/12.

²⁷ Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet. Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Ndryshimet ligjore të Shqipërisë gjatë kësaj periudhe janë evidentuar edhe nga Komisioni Evropian në kuadër të progres Raportit për Shqipërinë të prezantuar në Tetor 2020. Sipas tij, në dhjetor të vitit 2019, Shqipëria miratoi masa shtesë për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, veçanërisht duke rritur kontrollimin e policisë së shtetit mbi të miturit që largohen nga vendi. Komisioni nxjerr në pah miratimin në janar të vitit 2020, të paketës së veçantë që prezanton masa të përkohshme parandaluese për të rritur kapacitetin e vendit për të luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin (njohur ndryshe si paketa “*kap çfarë të kapësh*”, ose “KÇK”). Masat përfshijnë mundësinë e etiketimit të pasurive përmes sekuestrimit dhe konfiskimit, kufizimin e lëvizjeve të kriminelëve të dyshuar dhe kufizimin e aktiviteteve të tyre ekonomike. Paketa vë në dispozicion të Prokurorisë së Posaçme një sërë mjedesh të reja të rëndësishme hetimore dhe parashikon ndryshime në ligjin antimafia, ligjin “Për Policinë e Shtetit”, ligjin mbi administrimin e pasurive të sekuestruara, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurave Penale²⁸. Duke marrë në konsideratë ndryshimet e mësipërme, Komisioni Evropian ka konkluduar se Shqipëria ka aktualisht një kuadër të konsoliduar ligjor për konfiskimin e produkteve të krimit. Ajo që evidentohet ende si boshllëk është mungesa e një kuadri ligjor që synon pasurinë e pajustificuar, p.sh. në lidhje me futjen e konceptit të konfiskimit të zgjatur dhe të tavanëve të ligjshme financiare sa u takon transaksioneve në mjete monetare *cash*, pranueshmërinë e “raporteve të transaksioneve të dyshimta” si prova përpara gjykatës, dhe krijimin e një regjistri qendror të llogarive bankare.²⁹

1.4 Masat e dënimit në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe respektimi i standardeve ndërkombëtare

1.41 Format e dënimeve kryesore të parashikuara në Kodin Penal shqiptar për kryerjen e krimeve janë :³⁰

- a) me burgim të përjetshëm
- b) me burgim
- c) me gjobë³¹

1.42 Ashpërsia e dënimeve të përcaktuara për veprat penale kundër trafikimit të personave (Neni 110/a/b/c dhe neni 128/b të Kodit Penal) **është e krahueshme me dënimet e parashikuara për veprat e tjera penale që bëjnë pjesë në të njëjtën kategori të veprave penale kundër lirisë së personit.** “Trafikimi i personave të rritur” dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Ndërkohë që, nëse kjo vepër kryhet ndaj personave vulnerabël siç mund të jenë gratë apo fëmijët atëherë masa e dënimit të parashikuar është më e rëndë³² në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

1.43 Gjithashtu po në përputhje me këtë parim vlen të nënvizojmë faktin e përdorimit të konceptit të “**pozitës rënduese**” të subjektit në kryerjen e veprës së trafikimit të personit

²⁸Komisioni Evropian, Progres Raporti për Shqipërinë, Tetor 2020, fq 39.

²⁹ Komisioni Evropian, Progres Raporti për Shqipërinë, Tetor 2020, fq 39.

³⁰Analizë e indikatorit A1.

³¹Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 29 “Dënimet kryesore”

³²Nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë në rastine trafikimit të femrave dhe nga dhjetë deri në njëzet vjet kur vepra kryhet ndaj fëmijëve.

e cili gjithashtu shoqërohet me një rritje të masës së dënimit. Kështu në rastin e trafikimit të kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë ose kur trafikimi shoqërohet me keqtrajtimin apo detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, ose vepra sjell pasoja të rënda për shëndetin ose rrezikon jetën e tij atëherë masa e dënimit të parashikuar është jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Ndërkohë që në të njëjtën linjë me të gjitha veprat e sipërpërmendura edhe në rastin e trafikimit, ligjvënësi parashikon masën e dënimit me burgim të përjetshëm në rast se si pasojë e kryerjes së saj ka ardhur vdekja e personit. Rrethanë tjetër rënduese që rrit masën e dënimit të parashikuar në Kodin penal është edhe kryerja e saj përmes shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik e cila, nëse provohet, rrit me ¼ masën e dënimit kryesor të dhënë më parë.

- 1.44 Si rrjedhim mund të vlerësojmë se ndjekja e një politike të tillë të përcaktueshmërisë së dënimit **reflekton përgjithësisht frymën e Këshillit të Evropës** i cili në Konventën Kundër Trafikimit parashikon si rrethana rënduese në vendosjen e dënimit kryerjen e veprës penale të trafikimit kundër fëmijëve, kur rrezikohet jeta e viktimës, kur kryhet nga një nëpunës shtetëror në kryerjen e detyrave të tij/saj apo kur kryhet brenda kuadrit të një organizate kriminale.³³³⁴ Po kështu kjo politikë dënimi, që në arsyetimin tonë **reflekton nocionin e efikasitetit** në drejtim të qasjes kryerja e veprës – *pasoja që vijnë nga kryerja e saj të parashikuar edhe nga Direktiva 2011/36/BE* sipas të cilës kur krimi kryhet në rrethana të caktuara, përsëmbull, ndaj personave vulnerabël atëherë masa e dënimit duhet të jetë më e rëndë. E njëjta situatë parashikohet edhe në rastin kur vepra është veçanërisht e rëndë, përsëmbull kur jeta e viktimës vihet në rrezik ose vepra ka përfshirë forma serioze të dhunës si tortura, përdorimi me dhunë i lëndëve narkotike, përdhunimit ose forma të tjera të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale. Në të gjitha këto raste direktiva parashikon që këto rrethana të konsiderohen si rrethana rënduese të cilat të gjejnë reflektim në parashikimin e dënimit.³⁵
- 1.45 **Megjithatë edhe brenda këtyre dy dispozitave ka raste kur ligjvënësi nuk ka parashikuar siç duhet aplikimin e rritjes së dënimit në rrethana rënduese.** Kështu edhe pse organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të personave konsiderohet rrethanë rënduese, **sërisht masa e dënimit jo vetëm që nuk është rritur, por në të kundërt parashikohet më e ulët** (nga shtatë-pesëmbëdhjetë vjet). Ndërkohë që në rastin e Nenit 128/b kjo rrethanë parashikohet me të njëjtën masë dënimi si edhe vetë trafikimi i fëmijëve.
- 1.46 Ndërkohë që po në drejtim të marrjes së masave parandaluese shteti shqiptar ka miratuar ligjin Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” “përditësuar në 2017 i cili parashikon konfiskimin apo sekuestrimin e pasurive të vëna si rrjedhim i veprës penale të trafikimit të personave të rritur/fëmijëve.³⁶
- 1.47 Hetimi dhe ndjekja e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore (të rritur dhe fëmijë), si pjesë e krimeve të rënda edhe për shkak të masës së dënimit, ishte në kompetencën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda.³⁷ Ndërkohë që, me ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale në 2017, të dyja këto vepra do të jenë në juridiksionin lëndor të gjykatave të juridiksionin të zakonshëm,

³³Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, Neni 24 “Rrethana rënduese”.

³⁴ Shih gjithashtu United State Department of State. 2019 Trafficking in Persons Report: Albania ku nënvizohet se masat e ndëshkimit të vendosura në ligjin penal shqiptar janë të rënda krahasuar me ato të krimeve të ngjashme si psh përdhunimi.

³⁵ Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit miratuar me 5 Prill 2011 “Mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit” paragrafi 12/ preambula.

³⁶Indikator A.19.

³⁷Ish Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale.

ndryshim ky që në arsyetimin e ekspertëve të fushës është cilësuar jo në përputhje me standardet e parashikuara në Konventën e OKB, e cila i cilëson veprat e trafikimit të qenieve njerëzore si krime të rënda.³⁸ Ky ndryshim i tillë ka sjellë edhe vështirësi praktike dhe vonesa në shqyrtimin e rasteve të viteve 2018/19 për shkak të moskompetencës së shpallur nga Prokuroria e Krimeve të Rënda në drejtim të Prokurorive të Rretheve.³⁹

1.5 Juridiksioni mbi veprat penale të trafikimit përcaktuar në ligjin penal dhe procedural shqiptar dhe përcaktueshmëria e “trafikimit të qenieve njerëzore” si vepër penale e ekstradueshme .⁴⁰

1.51 Zbatimi i ligjit penal shqiptar për veprat penale të kryera nga shtetas shqiptarë dhe të huaj gjen referim në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal (Nenet 5-7 dhe 11). Në kuptim të këtyre neneve legjislacioni penal shqiptar zbatohet në të gjithë territorin e shtetit shqiptar. Për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë zbatohet ligji penal i Republikës së Shqipërisë. Në rastin e kryerjes së krimeve nga shtetasi shqiptar në territorin e një shteti tjetër, ligji penal i RSH vepron kur krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj. Parimi i mësipërm është i përgjithshëm dhe nuk i referohet shprehimisht veprës së trafikimit të personave. *Në rastin e veprave të kryera jashtë ndaj shtetasit shqiptar KP parashikon shprehimisht aplikimin e ligjit penal shqiptar në rastin kur shtetasit e huaj kanë kryer jashtë Shqipërisë trafikimin e personave, grave apo fëmijëve.* (Neni 7 KP). Lidhur me ekstradimin, bazuar në Nenin 11 të KP shihet se trafikimi i personave nuk bën pjesë në kategorinë e veprave penale për të cilat ndalohet ekstradimi. Ndalime të tilla bëhet vetëm për vepra me objekt politik ose ushtarak.

1.6 Mungesa e parashikueshmërisë në legjislacinin shqiptar të dënimit të viktimave të trafikimit si edhe parashikimi për lirimin e tyre nga paraburgimi. (indikator A22-23)

1.61 Neni 52/a i KP “Përfundimi ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat” parashikon në paragrafin e dytë të se “personi i dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojë përfundimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t’i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme”. **Në rastin e viktimave të trafikimit, dispozita gjen zbatim vetëm në rastet e bashkëpunimit ose kallëzimit.** Viktimat e trafikimit nuk duhet të ndeshkohen apo ndiqen penalisht për veprimet e paligjshme kur janë të detyruara ose si pasojë e vepres së trafikimit. Në praktikë, nga të dhënat e qëndrave të Koalicionit Antitrafik Kombëtar (qendra Psiko Sociale “Vatra” dhe të Ndryshëm dhe të Barabartë) ka pasur raste kur viktimat janë ndjekur penalisht për ushtrim prostitucioni megjithëse kanë qenë viktime të trafikimit. Gjithashtu, viktimat janë ndjekur penalisht edhe për vjedhje nderkohe që kanë qenë të detyruara ta kryenin ato vepra. Në raste të tilla, VT/VMT kanë kryer edhe ndeshkimin me burg. Mosdenimi i personave të trafikuar është një standard shumë i rendesishëm, me një dispozitë të vecante në Konventën e Keshillit të Evropës kundër trafikimit. Po kështu është me

³⁸Shih për më tepër Qendra “Të ndryshëm dhe të barabartë” (2019) “Raport studimor mbi nevojën e hartimit të një ligji të vecantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit në Shqipëri”, fq 46-7.

³⁹ Në dy rastet e analizuara nga “Vatra” dhe “Të ndryshëm dhe të Barabartë” ky ndryshim ligjor ka sjellë probleme në shqyrtimin e çështjeve të viktimave të trafikimit.

⁴⁰Indikator A 20/21.

rëndësi edhe parashikimi shprehimisht i detyrimit për lirimin e viktimave të trafikimit nga paraburgimi.

Rekomandime në drejtim të Indikatorit të Grupit Aa:

- *Nevojitet hartimi i një ligji kuadër kundër trafikimit të qenieve njerëzore (Reference Studimi “Të ndryshëm dhe të Barabartë” (2019)*
- *Nocioni i gjendjes së vulnerabilitetit i parashikuar nga nenet 110/a KP duhet të zgjerohet me kriteret e tjera lidhur me moshën, gjininë, gjendjen shëndetësore, paaftësinë fizike dhe/ ose mendore.*
- *Është i nevojshme aplikimi i konceptit të “pozitës rënduese” në lidhje me dispozitat për parashikojnë dënimin për veprën penale të organizimit, drejtimit apo financimi i trafikimit të personave.*
- *Nevojitet rishikimi i dispozitave të KP për të dalluar në ligjin penal të veprës së “trafikimit të personave të rritur” dhe “shfrytëzimit të rëndë ekonomik” të të rriturve si edhe për të parashikuar në KP në mënyrë të shprehur të mungesës së rëndësisë së dhënies së pëlqimit për efekt të trafikimit të personave të rritur.*
- *Kodi penal duhet të përfshijë konceptin e ndalimit të ndëshkimit të viktimës së trafikimit brenda nenit 52/a KP në përputhje me Konventën e KE*
- *Është me rëndësi marrja e masave për analizën dhe rishikimin e neneve 128/b dhe 110/a, të Kodit Penal, mbi trafikimin e personave, për të përfshirë në një nen të vetëm trafikimin e të rriturve dhe të miturve dhe për ta përfshirë trafikimin e fëmijëve në rrethanat rënduese të kryerjes së VP si edhe përcaktimi në legjislacionin i kuptimit të “shërbimeve të detyruara” në kuadër të formave të shfrytëzimit.*

2. IDENTIFIKIMI I VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT: GJETJE TË SHQIPTAR.

Identifikimi i viktimave të trafikimit/ kuadri ligjor dhe rezultatet për 2019

2.1 Identifikimi i viktimave të trafikimit në Shqipëri bazohet në Vendimin Nr.499 datë 29.8.2018 “ *Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit*” (PSV). Ky vendim parashikon në mënyrë të qartë format e identifikimit të viktimave të trafikimit (identifikimi fillestar dhe formal) si edhe organet përgjegjëse të ngarkuara me detyrën e identifikimit. Procedurat **janë hartuar në të njëjtën frymë me instrumentet ndërkombëtare** që trajtojnë çështjet e parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të personave, si dhe reflektojnë rekomandimet e dhëna për të njëjtën fushë veprimi nga organizma ndërkombëtare, si: OKB, DASH, KiE, IOM, OSBE, UNICEF, ICMPD, UNODC.⁴¹

2.2 Në lidhje me identifikimin fillestar PSV përcaktojnë si institucion përgjegjës për kryerjen e identifikimit në kufijtë e RSH-së, Policinë e Kufirit (të gjelbër dhe blu). Ndërkohë që, në territorin e RSH-së agjencitë përgjegjëse për identifikim fillestar janë agjencitë shtetërore dhe joshtetërore, përfshirë: KKSAT, qendrat e përkujdesjes shoqërore për persona në nevojë, organizatat me programe të ndihmës për persona në nevojë, zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror në qarqe, strukturat e policisë së shtetit, inspektorati shtetëror i punës, shkollat dhe institucionet arsimore, institucionet e kujdesit shëndetësor, strukturat e shërbimeve sociale në bashki. Jashtë territorit të RSH-së, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit me shtetësi shqiptare, janë punonjësit e përfaqësive diplomatike të RSH-së, si dhe agjenci të tjera shtetërore dhe joshtetërore me veprimtari në fushën e mbrojtjes së viktimave të trafikimit.⁴²

2.3 Ndërkohë që për identifikimin formal organ përgjegjës është Grupi/ Struktura Përgjegjëse për Identifikimin Formal në kufijtë dhe territorin e RSH-së (G/SPIF): i ngritur (ad hoc) që kryen intervistimin formal të personave që identifikohen si viktima të mundshme të trafikimit, e përbërë nga një punonjës i policisë së shtetit i seksionit të luftës kundër trafikeve të paligjshme (SLKTP) dhe punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve/NJMF në bashki/njësi administrative për çdo rast të të miturve dhe një punonjës social shtetëror i zyrës rajonale të shërbimit social shtetëror (ZRSHTSH) për të rriturit.⁴³ Për secilin nga institucionet e mësipërme PSV përcaktojnë qartë treguesit e nevojshëm për identifikimin e VT/VMT të rritur dhe/ose fëmijë si edhe hapat që duhet të ndiqen në çdo rast. Për identifikimin formal mjet është intervista formale dhe konsultimi me Autoritetin Përgjegjës.

2.4 Koncepti i “Viktimës së mundshme trafikimi” (VMT) gjendet i përkufizuar në mënyrë të

⁴¹ Nr. 499, datë 29.8.2018 Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, fq 4.

⁴² Nr. 499, datë 29.8.2018 Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit,, fq.18.

⁴³ Nr. 499, datë 29.8.2018 Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, fq 60.


shprehur në VKM Nr. 499, datë 29.8.2018 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”. Në kuadër të këtij akti, VMT është personi, për të cilin/cilën, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar, bazuar në treguesit/indikatorët/dritën e rrethanave të veçanta të rasteve, në të cilën, të paktën tre ose më shumë elementë **përbëjnë dyshimin e arsyeshëm se personi mund të jetë trafikuar**. Në kuadrin ndërkombëtar, subjektet e mësipërme të cilat formalisht nuk janë identifikuar nga organet përgjegjëse konsiderohen si viktimë të prezumuar të trafikimit. Ndërkohë që në referencat ndërkombëtare VMT janë ato grupe vulnerabël të cilët mund të jenë të riskuar për t’u bërë VT në të ardhmen.⁴⁴ Edhe nëse i referohemi raporteve të GRETA-s për Shqipërinë termi që përdoret në kuptimin e VMT sipas kuadrit tonë ligjor është **“viktimë e prezumuar e trafikimit”**. Në këtë drejtim është me rëndësi përfshirja në PSV e nocionit të Viktimës së Prezumuar të Trafikimit si zëvendësim të VMT me qëllim shmangien e interpretimit të gabuar në rast të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Bazuar në të dhënat e raportit të DASH për vitin 2019, institucionet shtetërore të përfshira në identifikimin e VT/VMT kanë identifikuar 43 nga 103 viktimë në total të regjistruara për vitin 2019. 42 Viktimë janë identifikuar nga nëpunësit e njësive lëvizëse të identifikimit të viktimave, 14 VMT/VT janë identifikuar nga OJF dhe organizata ndërkombëtare, 2 nga koordinatori Serbi dhe Kosovë, 1 nga komuniteti dhe 1 viktimë është vetëidentifikuar. Lidhur me identifikimin e VMT/VT në rrugët migratore, strukturat e policisë kufitare tashmë janë të trajnuara dhe kanë informacionin e duhur mbi identifikimin e migranteve VMT. Vetëm në 2019 ka pasur 2 raste VMT të identifikuara si azilkërkues. Në lidhje me viktimat fëmijë, **mбетet e nevojshme rritja e kapaciteteve të inspektoratit shtetëror të punës në lidhje me identifikimin e viktimave të punës së detyruar** dhe identifikimi i rasteve të detyrimit për lypje kryesisht midis fëmijëve të pashoqëruar, fëmijëve të rrugës apo fëmijëve që kalojnë kufijtë për lypje.⁴⁵ Me interes është të përmendet fakti se gjatë 2019, 2 viktimë të mundshme trafikimi janë identifikuar nga sistemi arsimor.

⁴⁴ Shih dallimin midis VMT dhe Viktimave të prezumuara të trafikimit : OSCE (2011) Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims A Community Policing Approach ose Office for Democratic Institutions and Human Rights, *National Referral Mechanisms. Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons. A Practical Handbook*, Warsaw, 2004

⁴⁵ US Department of State (2020) Trafficking in Persons Report: Albania

Të dhëna mbi identifikimin e viktimave të trafikimit Janar-Dhjetor 2019	103 VMT/VT	
	Seksi	
	Meshkuj Nr/%	Femra Nr/%
	23 / 22 %	80 / 78%
	Mosha	
	Të rritur Nr / %	Fëmijë Nr/ %
	36/ 35%	67 / 65%
	Kombësia	
	Shqiptare Nr/ %	Të huaj Nr /%
	97/94%	6/6%
	Statusi	
	VT Nr / %	VMT Nr/%
	7/7%	96 / 93%



Grafik: Numri i VT/VMT të identifikuara gjatë 2019 sipas strukturave të identifikimit

Burimi: Departamenti Amerikan i Shtetit (2020)

- 2.5 Nga numri total prej 103 VT/VMT gjatë 2019, 96 janë identifikuar nga autoritetet shtetërore, orgaanizatat jo qeveritare dhe njësitë e lëvizjes si Viktima të mundshme trafikimi dhe 7 si Viktima zyrtare VT. Prej këtyre 6 shtetas ishin të huaj dhe 97 viktima shqiptare. 93 raste janë konsideruar si raste të trafikimit të brendshëm. Nga totali i VMT/VT, 36 ishin të rritur dhe 67 fëmijë, prej të cilave 80 ishin të seksit femër dhe 23 meshkuj. Në rastin e viktimave të mitur nuk ka të dhëna në lidhje me ekzistencën e rasteve kur të miturit janë konsideruar si të rritur gjatë identifikimit dhe janë ankuar për t'u konsideruar si VMT të mitur. Shpërndarja kryesore e rasteve ka qënë Elbasan (27) , Tiranë (23), Vlorë (16), Korçë (5), Dibër (5), Berat (4), Durrës (3) , Kukës (3) dhe Fier (2) .
- 2.6 Ndërkohë sipas burimeve të qendrave të Koalicionit Kombëtar Antitrafik për vitin 2020 rezulton se gjatë periudhës janar – dhjetor 2020 janë identifikuar 84 VMT. 5 viktima janë identifikuar si viktima zyrtare trafikimi. Në total nga 84 VT/VMT 28 kanë qënë të rritur dhe 56 fëmijë nga të cilët 22 kanë qënë meshkuj dhe 62 femra. Vetëm 3 shtetas janë identifikuar gjatë kësaj periudhe si VMT/VT të huaj, ndërkohë që 81 viktima janë identifikuar si shtetase shqiptare.⁴⁶
- 2.7 Në lidhje me formën e shfrytëzimit, sipas Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) dhe raportit të GRETA-s, të paktën 80% e viktimave janë subjekt i trafikimit seksual dhe vetëm 20 % e tyre subjekt i punës së detyruar lypjes së detyruar.⁴⁷ Vajzat dhe gratë trafikohen më tepër për shfrytëzim seksual, ndërsa burrat dhe djemtë për punë të detyruar ose lypje. Organet përgjegjëse për identifikimin në këtë rast të formave të shfrytëzimit janë të lidhura me organet e policisë si dhe inspektorati i punës. *Megjithatë, po sipas DASH, këtyre organeve iu mungon trajnimi për të identifikuar viktimat e punës së detyruar sipas grupmoshës apo gjinisë.*⁴⁸ Gjithashtu në lidhje me autoritetin përgjegjës për identifikimin e viktimave të shfrytëzuara për punë të detyruar mund të themi se nuk ekziston një autoritet i ndarë për identifikimin vetëm të viktimave meshkuj ose femra. (shih indikator B.18/19). Në rastin tonë, Inspektorati i Punës vepron si një organ i vetëm që do të duhet të mbledhë të dhëna në lidhje me këto indikatorë.
- 2.8 Në lidhje me hetimin dhe ndjekje e veprave penale të trafikimit mund të themi se gjatë vitit 2019 Policia e Shtetit ka hetuar 41 raste me 62 të dyshuar nga të cilat 34 raste me 45 të dyshuar lidheshin me trafikimin e të rriturve dhe 7 raste me 17 të dyshuar lidheshin me trafikimin e fëmijëve. Në të njëjtën periudhë gjatë vitit 2019, Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar gjithsej 19 procedime për nenin 110/a të KP me tetë të pandehur/persona nën hetim dhe 6 procedime me në lidhje me trafikimin e fëmijëve (neni 128/b) dhe ka dërguar për gjykim tre çështje me 3 persona të pandehur. (1 për trafikimin e të rriturve dhe 2 për trafikimin e fëmijëve).⁴⁹ Për periudhën e monitorimit (2019) raportet zyrtare

⁴⁶ Burimi i të dhënave të mbledhura është Zyra Kombëtare e Koordinatorit AntiTrafik, referuar nga Qendra Psiko Sociale “Vatra”

⁴⁷United States Department of State, (2020) Trafficking in Persons Report:Albania,

⁴⁸Ibid.

⁴⁹ Indikatorë A.27

nuk raportojnë asnjë rast të zyrtarëve të lartë të dyshuar si të përfshirë në trafikimin e qënieve njerëzore ose që kanë qenë në një farë mënyre bashkëpunorë me trafikantët.⁵⁰

2.9 Mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit është e garantuar gjatë fazës së ndjekjes penale. Në të gjitha rastet e fëmijëve që janë paraqitur për të dëshmuar përpara prokurorit është siguruar marrja e tyre në pyetje nga prokurori për të mitur si edhe është siguruar prezenca e psikologut. VT/VMT janë njohur paraprakisht me të drejtat e tyre dhe për të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe gjyqësore.⁵¹⁵²

2.10 Bazuar në të dhënat e strehëzave që ofrojnë shërbime për VT/VMT, gjatë 2019 ka pasur disa raste kur ndjekja penale ose prokuroria është kufizuar në ushtrimin e detyrës së saj/ndaluar për shkak të familjarëve apo ngurrimit të viktimës. Kështu nga informacioni i marrë nga qendra “Të ndryshëm dhe të Barabartë”, gjatë 2019 ka pasur 1 rast fëmije të mitur (e cila trajtohej pranë qendrës) e cila është detyruar nga nëna e saj për të tërhequr padinë pas kërcënimeve të abuzuesve për hakmarrje. Pas zbulimit të vendndodhjes, rasti është transferuar në një qendër të sigurisë së lartë dhe më tej kanë vazhduar procedurat ligjore. Raste të detyrimit të VT për të tërhequr padinë janë vënë re edhe në rrethanat kur në trafikim janë përfshirë familjarët e viktimës. I tillë ka qenë rasti i identifikuar nga avokatët e qendrës “Të ndryshëm dhe të Barabartë” gjatë 2019, i shfrytëzimit të një minoreneje nga familjarë të saj. Në rastin konkret ka pasur ndërhyrje të nënës tek vajza për të tërhequr padinë kundër babait dhe vëllait. Viktima minorene në këtë rast është mbështetur nga psikogjia dhe avokatja e Qendrës për të vazhduar procedurat dhe për t’u përfaqësuar në gjykatë.⁵³ Po kështu edhe Qendra Psiko – Sociale “Vatra” pohon se është vërejtur se ka patur raste kur viktimat e trafikimit kanë ndryshuar deklaratën në prokurori apo gjykatë duke mohuar shfrytëzimin e tyre.⁵⁴ Kjo për faktin se kanë qenë të intimiduara, kërcënuara nga trafikantët, të afërm të tyre apo vet avokatët e trafikantëve. Gjithashtu në mjaft raste viktimat janë nën presionin e familjarëve për ndryshimin e dëshmisë, duke qenë se ndaj tyre ka patur kërcënime për jetën.

2.11 Referuar statistikave gjyqësore, gjatë 2019, janë dënuar nga Gjykata 5 shtetas nga të cilët tre janë dënuar për trafikim e të rriturve dhe 2 për trafikimin e fëmijëve. Masa e dënimit për trafikantët e të rriturve është dhënë respektivisht 7 vjet e gjashtë muaj, 10 dhe 17 vjet burgim ndërkohë që të dyja rastet e trafikimit të fëmijëve janë dënuar me 15 vjet burgim.⁵⁵ Në të gjitha proceset gjyqësore sipas të informacioneve të marra nga strehëzat që ofrojnë shërbime për VT/VMT dhe raporteve të Koordinatorit kombëtar anti-trafik, gjykatat kanë respektuar parimin e mosdiskriminimit në trajtimin e çështjeve duke iu ofruar të gjitha palëve mundësi dhe të drejta të barabarta.⁵⁶ Gjithashtu, proceset gjyqësore janë realizuar duke respektuar masat e mbrojtjes së dëshmitarëve viktimat. Kështu gjatë 2019 është identifikuar 1 rast i ndjekur nga QND ku viktimës minorene i është marrë dëshmia me video për të mos u përballur me të pandehurin dhe 2 raste të tjera të cilat janë

⁵⁰ Indikator A.25

⁵¹ Indikator A.32/33/34.

⁵² Informacioni i marrë sipas të dhënave të avokatëve të Qendrës “Të ndryshëm dhe të Barabartë” që kanë qenë prezentë në takimet e VT/VMT me prokurorët.

⁵³ Indikator A.36

⁵⁴ Nga 10 rastet e monitoruara nga qendra Vatra për 2019-2020, të paktën në 1 rast është verifikuar ndryshimi i dëshmisë së VT.

⁵⁵ United States Department of State, (2020) Trafficking in Persons Report:Albania

⁵⁶ Indikator A.39

pyetur paraprakisht nga gjyqtarët nëse duan të përballen ose jo me të pandehurit. Në të dyja rastet gjykata ka respektuar vendimet e viktimave.⁵⁷

- 2.12 Jo e njëjta situatë paraqitet në rastin e VT/VMT të rritura. Në rastet e ndjekura nga qendra psiko sociale “Vatra” ka pasur të dhëna të refuzimit të përdorimit të mediave audiovizive nga ana e gjykatës duke detyruar viktimën të japë dëshmi në të njëjtë seancë gjyqi bashkë me të pandehurit për trafikim. Në këtë rast gjykata nuk ka marrë parasysh as kërkesën e avokatëve të qendrës për të mundësuar marrjen e dëshmisë me mjete audiovizive, gjë që në praktikë ka sjellë probleme edhe në lidhje me ndryshimin e dëshmive të VT/VMT për shkak të frikës nga prezenca e personave që i kanë shfrytëzuar. Kohëzgjatja mesatare e procesit të gjykimit të çështjeve të trafikimit të qënieve njerëzore sipas OJF që kanë ndjekur proceset ka variuar nga një deri në 3 vite⁵⁸.
- 2.13 Gjatë periudhës së monitorimit që mbulon ky raport nuk ka pasur raste të viktimave të dënuara për përfshirje në aktivitete të paligjshme për të cilat ato ishin të detyruara t’i kryenin nën kontrollin e trafikantëve apo shfrytëzuesve të tyre.⁵⁹
- 2.14 Referuar strukturave të hetimit dhe ndjekjes së rasteve të trafikimit të qënieve njerëzore vlen të përmendet fakti se në nivel të policisë së shtetit funksionon struktura e Anti-Trafikut e cila është përgjegjëse për hetimin e të gjitha rasteve të trafikimit të personave. Ndërkohë në nivel prokurorie dhe gjykate, pas ndryshimeve 2017, SPAK do të hetojë rastet e trafikimit nëse ato kategorizohen si krim i organizuar ndërsa prokurorët e rretheve vazhdojnë të procedonin rastet në mungesë të elementëve të krimit të organizuar. Nga monitorimi i strukturave ndërkombëtare dhe OJF është evidentuar mungesa e kapaciteteve të prokurorëve të rretheve për të hetuar këtë kategori të veprave penale dhe për të ndjekur penalisht me sukses çështjet e trafikimit. Sipas DASH, problemet lidhen me mungesën e specializimit të prokurorëve për të dalluar elementët e veprës penale të shfrytëzimit seksual nga trafikimi i personave, gjë që sillte pasojë edhe në lidhje me aplikimin e dënimeve në masa më të ultëta në një pjesë të rasteve.⁶⁰
- 2.15 Po kështu pavarësisht përpjekjeve të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar, OJF dhe organizatave ndërkombëtare për të trajnuar organet referuese gjatë vitit 2019, nga monitorimi del nevoja për njohje më të mirë të tyre të PSV dhe masave mbrojtëse për viktimat. Ndërkohë që është e nevojshme të ketë statistika të plota mbi trajnimin e profesionistëve, numrin e trajnimeve si edhe numrin e përgjithshëm të përfituesve të trajnimit në çdo rast.

⁵⁷ Indikator A.40. (sipas të dhënave të QNB)

⁵⁸ Indikator A.52

⁵⁹ Indikator A.41.

⁶⁰ Ibid.

Rekomandime në lidhje me identifikimin e VT/VMT:

Rekomandohet:

- Kryerja e identifikimit duke respektuar të gjitha hapat procedurale të PSV, pavarësisht kallëzimit në prokurori.
- Përcaktimi i indikatorëve të vecantë në lidhje me VT dhe VMT të nevojshme për mbledhjen e statistikave në planin statistikor;
- Hartimi i statistikave në lidhje me numrin e përgjithshëm të personelit të Autoritetit Përgjegjës që kanë marrë trajnim nga Zyra e Koordinatorit Anti-Trafik gjatë gjithë vitit;
- Rritja e kapaciteteve të punonjësve të inspektoriatit të punës mbi identifikimin e viktimave objekt shfrytëzimi puna e detyruar.
- Zgjerimi i rrethit të trajnimeve me strukturat përgjegjëse në të gjithë njësitë territoriale të RSH si edhe trajnimi i specialistëve të zonave kufitare, azilit, diplomatëve në lidhje me identifikimin e viktimave të trafikimit.
- Krijimi i një sistemi të dhënash mbi identifikimin e VMT/VT i aksesueshëm nga të gjithë strukturat e Autoritetit Përgjegjës dhe marrja e masave për eliminimin e mbivendosjes së të dhënave midis strukturave policore, prokurorisë apo gjykatës.
- Përfshirja në PSV e konceptit të viktimës së prezumuar të trafikimit në vend të Viktimës së Mundshme të Trafikimit.
- Rritja e kapaciteteve të organeve të hetimit dhe ndjekjes penale të çështjeve të trafikimit të qënieve njerëzore për të dalluar elementët e veprave të ndryshme penale në këtë kategori dhe për të kualifikuar saktë veprën penale të trafikimit.
- Mbajtja e të dhënave në lidhje me numrin e dëshmitarëve pjesë e procesit, numrin e rasteve të ndaluara nga prokuroria për shkak të tërheqjes së akusëz nga VT/VMT, numrin e rasteve që përfshijnë shtetas të huaj.

3 MBROJTJA E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT: GJETJE TË SHQIPTAR GJATË 2019

3.1 Mbrojtja ligjore për viktimat e trafikimit

3.11 Legjislacioni shqiptar parashikon në disa akte mbrojtjen e viktimave të trafikimit. PSV përcaktojnë qartë dallimin midis VT dhe VMT duke pasur parasysh në lidhje me këtë të fundit ekzistencën e të paktën tre ose më shumë elementëve që bazuar në treguesit/indiktorët apo rrethanat e rastit përbëjnë dyshim për autoritetin përgjegjës se personi mund të jetë trafikuar. Po kështu PSV përcaktojnë edhe formatin e intervistës si për të rriturit ashtu edhe për fëmijët. Është shumë e rëndësishme identifikimi i shpejtë i VT/VMT për shkak se ato mund të jenë subjekte në nevojë të ndihmës së specializuar dhe shërbimeve mbështetëse të cilat synojnë riintegrimin dhe rikuperimin e plotë fizik, social apo psikologjik të viktimës. Kuadri ligjor shqiptar, në lidhje me garantimin e masave mbrojtëse për VT/VMT është hartuar mbi bazën e standardeve minimale mbrojtëse të parashikuara në Nenin 12 të Konventës së KE.⁶¹ Si pjesë e masave mbrojtëse me karakter ligjor, referuar në ligje të veçanta mund të përmendim:

- a) Të drejtën për të përfituar ndihmës juridike falas⁶²
- b) Të drejtën për të përfituar nga programi i mbrojtjes së dëshimtarëve apo bashkëpunorëve të drejtësisë⁶³
- c) Të drejtën për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike pas daljes nga institucioni i përkujdesit shoqëror deri në punësimin e tyre⁶⁴
- d) Të drejtën e VT/VMT për t'u akomoduar në qendra të posaçme rezidenciale;
- e) Viktimat e huaja të trafikimit kanë të drejtën për leje pune për raste të veçanta e tipit “C” për qëllime biznesi, për t'u punësuar, vetëpunësuar ose për formim profesional⁶⁵
- f) Mbrojtja e identitetit dhe jetës private të VT/VMT^{66,67}

3.12 Gjithashtu përveç këtyre të drejtave, Kodi i Procedurës Penale RSH njih mundësinë e viktimës së veprës penale për të kërkuar shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal.⁶⁸

3.13 Amendamentet e Kodit të Procedurës Penale parashikuan një pozitë të re të viktimës në procesin penal⁶⁹. Në ndryshim nga pozita e mëparshme, tashmë viktimat e

⁶¹ Konventa e Këshillit të Evropës “Për veprim kundër trafikimit të qënieve njerëzore” parashikon si standarde minimale për mbrojtjen e VT/VMT masat: strehim i përshtatshëm dhe i sigurt; – ndihmë psikologjike; – ndihmë materiale; – akses në trajtim mjekësor urgjent; – shërbime përkthimi dhe interpretimi sipas nevojës; – këshillim dhe informim, veçanërisht për sa u përket të drejtave të tyre të ligjshme dhe procedurave përkatëse, në një gjuhë që ata e kuptojnë; – ndihmë ligjore dhe ndihmë juridike falas sipas kushteve specifike; – akses në tregun e punës, formimin dhe arsimin profesional, si dhe – akses në arsimin e fëmijëve, duke marrë në konsideratë sigurinë e viktimës dhe nevojat për mbrojtje

⁶² Ligj nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti:

⁶³ Ligji Nr. 10173 dt. 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshimtarëve dhe bashkëpunorëve të drejtësisë”, shih Neni 12

⁶⁴ Ligji Nr. 10252, datë 11.03.2010, “Për disa shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, neni 1

⁶⁵ Ligji Nr. 9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, Neni 60.

⁶⁶ Ligj “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

⁶⁷ Ligj Nr 108/2014 “Për Policinë e shtetit”; Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, Neni 21/4.

⁶⁸ Kodi Procedurës Penale, Neni 58/1/g.

⁶⁹ Shih: Aurela Anastasi. TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE NË PROCESIN PENAL (neni 58, 58/b të Kodit të Procedurës Penale), botuar në “Komentar i veprave penale të trafikimit të qënieve njerëzore, Të drejtat e viktimave të

veprës penale është palë në procesin penal dhe ka të drejta procedurale që i japin asaj një **rol aktiv në këtë proces**.

3.14 Krahës të drejtave që parashikohen rishtazi për viktimat e veprës penale në përgjithësi (neni 58), viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë edhe të drejta të parashikuara posaçërisht për to (58/b)⁷⁰. Viktima ka të drejtë të kërkojë ndjekjen penale, ndihmë psikologjike, të drejtën për të marrë këshillim dhe shërbim ligjor falas, të këshillohet në gjuhën që ajo e kupton, të ndihmohet në rastin e viktimave me aftësi të kufizuara, të zgjedhin mbrojtësin, të kërkojnë kohë për gjendjen e procedimit, të informohet për lirimin e trafikantit. Neni 58/b sanksionon të drejtat e viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit duke iu mundësuar atyre të drejtën të pyeten pa vonesë nga një punonjës polici i të njëjtës gjini, të drejtën për të mos ju përgjigjur pyetjeve private dhe të drejtën për t'u marrë në pyetje duke përdorur mjetet audiovizive.

3.15 Me shumë rëndësi është sanksionimi në ligj i të drejtës së viktimave të trafikimit për t'u përjashtuar nga shpenzimet gjyqësore dhe e drejta e viktimave për t'u kompensuar dhe dëmshpërblyer. Neni 37 i ligjit Nr. 10 192, datë 3.12.2009 i ndryshuar "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" parashikon krijimin e një fondi të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit i cili shërben përveç të tjerave edhe për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor. Megjithatë problem i evidentuar mbetet zbatimi i këtyre dispozitave. Deri në 2020 vetëm tre raste të VT/VMT kanë kërkuar me ndihmën e OJF të drejtën për t'u dëmshpërblyer. Përcaktimi i pagesës paraprake në vlerën 1% mbetet shqetësuese në rastin e ushtrimit të kësaj të drejte. Për më tepër edhe në rast të fitimit të së drejtës së viktimave në rrugë gjyqësore, problem i evidentuar ka qënë mungesa e ekzekutimit të vendimit, gjë që ka çuar në mungesën e marrjes së dëmshpërblimit faktik nga ana e viktimës.

3.16 Në lidhje me të drejtat shëndetësore, legjislacioni në fushën e kujdesit shëndetësor garanton gjithashtu mbulimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor për viktimat e trafikimit. ***Mungon parashikimi i të njëjtës së drejtë për viktimat e mundshme të trafikimit.***⁷¹ Megjithatë, në praktikë, nëpërmjet Autoritetit Përgjegjës në mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është lehtësuar vazhdimisht procesi i pajisjes me kartë shëndeti dhe ndjekja nga mjeku familjes respektive për të gjithë VT/VMT, pa dallim të statusit. Ligji iu mundëson viktimave të trafikimit të drejtën për ndihmë ekonomike. Megjithatë, ndihma ekonomike në shumën 3000 lek në muaj konsiderohet një shumë e pamjaftueshme as për nevojat jetike të viktimave të trafikimit.

trafikimit gjatë procesit penal", Prezenca e OSBE në Shqipëri 2017, fq. 51- 61, i vlefshëm në: <https://www.osce.org/sq/presence-in-albania/373351?download=true>

⁷⁰ idem

⁷¹ Shih Ligji 141/2014 datë 23.10.2014 për amendime të ligjit nr 10383 datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".

3.17 Me interes është të përmendet fakti se kuadri ligjor ofron të drejta për viktimat pavarësisht faktit nëse ato e kanë marrë apo jo statusin e viktimës së trafikimit. Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve është ndërmarrë në vitin 2005. Përpara vitit 2005, viktimat që përballeshin me rrezik real futeshin në mbrojtje të institucioneve ndërkombëtare. Qendra Psiko-Sociale Vatra me mbështetjen dhe bashkëpunimin e institucioneve ndërkombëtare përpara vitit 2005 ka ndihmuar për t'u përfshirë në programe mbrojtje 8 viktima të trafikimit njerëzor (një prej të cilave me fëmijë) dhe një tjetër në vitin 2009. Ndërkohë pas vitit 2005, me miratimin e ligjit detyrimi për mbrojtje i kaloi qeverisë shqiptare. Nga viti 2005-2020 vetëm dy viktima (njëra asistuar nga Qendra psiko – Sociale “Vatra” dhe tjetra nga Qendra “Të ndryshëm dhe të Barabartë”) janë përfshirë në këto programe mbrojtje dhe viktimat pas ndryshimit të identitetit janë zhvendosur në vendet e BE.

3.18 Po kështu, me rëndësi është parashikimi i veçantë për mbrojtjen, strehimin dhe ofrimin e ndihmës materiale për fëmijët viktima. Në këtë aspekt, vlen të përmendim qendrën “Tjetër Vizion” e cila është e specializuar për trajtimin e fëmijëve, viktima të trafikimit si edhe qendrat e tjera për trajtimin e fëmijëve mbi 15 vjec apo fëmijë të viktimave të trafikimit. Kuadri ligjor garanton ndihma mjeksore për fëmijët, aksesin e tyre në shërbimet e arsimit dhe formimit profesional. Fëmijët mund të lejohen të punojnë part time 4 orë në bizneset private.

3.19 Kuadri ligjor parashikon gjithashtu mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave në mënyrë adekuate gjatë periudhës në shqyrtim. Të katërta strehëzat që ofrojnë shërbime direkte për VT/VMT janë të mbrojtura. Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit (Linzë) mbrohet nga policia e shtetit ndërsa tre strehëzat e tjera janë të mbrojtura me polici private, me qëllim mbrojtjen e viktimave nga ndonjë kërcënim i mundshëm nga autorët e veprave penale.

3.20 Megjithatë, problematikë shqetësuese e pandryshuar vazhdon të mbetet mungesa e shërbimeve për viktimat e trafikimit me probleme të shëndetit mendor. Qendrat që ofrojnë shërbime për VT/VMT **nuk kanë në stafin e tyre mjek psiakiater 24 orë ose part time, gjë që ka sjellë refuzimin e hospitalizimit të personave me probleme të shëndetit mendor. Kjo problematikë sjell nevojën së pari për krijimin** qendre specifike për këto kategori dhe së dyti për fuqizimin real financiar të familjeve të viktimave me probleme të shëndetit mendor me qëllim që ato të kujdesen për fëmijët e tyre.

3.21 Një rast shumë i vështirë është trafikimi i të miturve për t'u shfrytëzuar për lypje. Të miturit në këtë rast shfrytëzohen nga prindërit për shkaqe të nevojave ekstreme ekonomike. Arrestimi, dënimi i prindërve në këto raste krijon shumë vështirësi për përkujdesjen e të miturve, të cilët duhet të vendosen në qendra të posaçme për marrjen dhe përkujdesjen e tyre.

3.2 Rezultatet e monitorimit mbi mbrojtjen e ofruar për VT/VMT (2019)⁷²

3.21 Sipas raportit për trafikimin e personave publikuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit rezulton se vetëm një Viktimë Trafikimi ka bashkëpunuar me institucionet e zbatimit të ligjit gjatë vitit 2019, të cilës i është ofruar mbrojtje e veçantë nga programi për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe bashkëpunorëve të Drejtësisë. Ndërkohë që, në

⁷² Grupi i indikatorëve C

asnjë nga raportet zyrtare nuk ka të dhëna për mbrojtjen e viktimave pas përfundimit të procesit gjyqësor.⁷³

3.22 Bazuar në PSV, VT/VMT ju jepet mbështetje, mbrojtje dhe siguri edhe po nuk bashkëpunuan me policinë apo zyrtarë të tjerë të zbatimit të ligjit. E vetmja masë e cila lidhet me bashkëpunimin me organet e drejtësisë dhe kallëzimin është përfitimi nga mundësia e përjashtimit nga masa e dënimit ose ulja të tyre siç parashikohet në Kodin Penal (Neni 52/a).

3.23 Mungojnë gjatë kësaj periudhe të dhëna/raste të cilat tregojnë për largimin/pasigurinë e viktimave të trafikimit pas një periudhe 6 apo 12 mujore pas kontaktimit me organizatën. Nuk ka gjithashtu të dhëna në lidhje me rastet që formalisht i janë siguruar masa mbrojtëse gjatë hetimit. Asnjë viktimë për 2019 nuk ka marrë mbrojtje lidhur me ruajtjen fizike, rialokimin apo ndryshimin e identitetit.

3.24 Referuar mbështetjes së VT/VMT gjatë periudhës së reflektimit dhe rikuperimit vlen të theksojmë se në kuptim të kuadrit tonë ligjor, periudha e reflektimit për VT/VMT është tre muaj. Nga të dhënat zyrtare të siguruara nga qendra Psiko- Sociale “Vatra”, gjatë 2019 rezulton 1 rast të cilit i është rinovuar leja e qëndrimit 2 herë gjatë vitit. Ndërkohë që gjatë 2020 ka pasur edhe tre raste të tjera (nga Nigeria, Filipine dhe Gambia) të cilëve po ashtu iu është ofruar e njëjta mbrojtje. Ndërkohë, në lidhje me mbrojtjen e ofruar gjatë periudhës së reflektimit nga të dhënat rezulton se gjatë periudhës 2019-2020, 5 VT/VMT janë asistuar me të gjitha shërbimet e nevojshme gjatë kësaj periudhe.

3.25 Gjatë 2019, 6 VT/VMT janë kthyer në Shqipëri⁷⁴. Të gjitha u kthyen me ndihmën e Autoriteteve Përgjegjëse të dy vendeve si dhe organizatave të shoqërisë civile në vendet e destinacionit dhe në Shqipëri. Sipas PSV-ve, stafi konsullor duhet të përfshihet në kthimin e asistuar të rasteve, por nga monitorimi rezulton se, edhe pse ka pasur 6 raste të kthyera të asistuar *ato janë bërë nëpërmjet OJF-ve në bashkëpunim me Autoritetin Përgjegjës në Ministrinë e Brendshme, duke munguar përfshirja e stafit konsullor*. Kthimet e asistuar janë bërë në përputhje me Procedurat Standarte të Veprimit. Para kthimit të rasteve është bërë gjithmonë vlerësimi i rrezikut si dhe në rastin e minoreneve është bërë edhe vlerësimi i familjes. Për të gjitha këto raste, menjëherë pas kthimit në Shqipëri, është ofruar një paketë e plotë shërbimesh riintegruese bazuar në nevojat e veçanta të gjithësecilit. Mungesa e indikatorëve mbi “riatdhësimet e detyruara” dhe VT e deportuara nga vendet e destinacionit në Planin e Veprimit të MB e bëjnë të pamundur monitorimin në lidhje me këta tregues për efekt të këtij raporti. (indikator C.46).

⁷³ Edhe nga informacioni i marrë nga strehëzat që mbështesin viktimat e trafikimit nuk ka asnjë masë të tillë gjatë vitit 2019.

⁷⁴ Viktimat janë kthyer nga Gjermania (1); Mbretëria e Bashkuar (2); Franca (1); Serbia (1); Danimarka (1) dhe një rast nga Shqipëria në Kosovë.

3.3 Mbrojtja e fëmijëve – viktimat të trafikimit/viktima të mundshme të trafikimit

3.31 Në mënyrë të posaçme kuadri ligjor shqiptar ofron mbrojtje të zgjeruar në lidhje me fëmijët-viktima trafikimi/viktima të mundshme trafikimi me qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës, riintegrimin e tyre në shoqëri si dhe marrjen e masave për ofrimin e shërbimeve arsimore, sociale, masa mjekësore etj.⁷⁵Bazuar në Ligjin 18/2017 *“Për të drejtat e fëmijëve”* qeveria shqiptare në bashkëpunim me një sërë organizatash kanë miratuar VKM të nevojshme për garantimin e mbrojtjes së fëmijëve.⁷⁶Po kështu në kuadër të mbrojtjes dhe asistencës së vt/vmt, më datë 26.08.2015 u miratua VKM nr. 707 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.107, datë 10.2.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollare të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar”, në të cilin parashikohet dhënia e librave falas për fëmijët viktima të trafikimit.*

3.32 Për vitin 2019 kanë marrë shërbim si raste VT/VMT pranë qendrës së specializuar Tjetër Vizion 23 fëmijë. Ndërkohë numri total i fëmijëve viktima që kanë marrë kanë marrë shërbime në 4 strehëzat që trajtojnë viktima trafikimi, por edhe në IPSH apo familje gjatë kësaj periudhe ka qënë 85. Identifikimi i tyre është bërë i bazuar në PSV për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit. Mbështetje financiare iu ofrohet vetëm fëmijëve viktima që strehon në qendrat anti-trafik shtetërore dhe OJF. Fëmijët të cilët janë identifikuar si VT/VMT kanë qënë të shfrytëzuar kryesisht për lypje. Por nuk kanë munguar raste të cilët janë shfrytëzuar edhe për shfrytëzim seksual. Në të gjitha rastet shërbimi që ofrohet për fëmijët është në përputhje me moshën dhe nevojat e vecanta të tyre.

3.34 Megjithatë, pavarësisht mbrojtjes së ofruar për fëmijët VT/VMT, sërish mungojnë të dhëna në lidhje me: a) fëmijët e pashoqëruar të identifikuar si viktima që iu është caktuar një kujdestar; b) fëmijët viktima trafikimi familja e të cilëve nuk është gjetur për një periudhë të arsyeshme nga koha e identifikimit të tyre;c) fëmijët që marrin këshillim ligjor si edhe d) numri i fëmijëve viktima /dëshmitarë gjatë fazës së procedimit; e) fëmijët viktima që janë strehuar në institucione të paspecializuara për trajtimin e fëmijëve. Për sa më sipër, për të pasur një panoramë më të plotë në lidhje me fëmijët viktima trafikimi/VMT është e nevojshme riformulimi i treguesve në nivel kombëtar duke shtuar edhe vlerësimin dhe mbledhjen e të dhënave edhe në lidhje me idikatorët e përmendur që janë pjesë e Instrumentit të Përshtatur të Monitorimit për Shqipërinë.

⁷⁵Shih në mënyrë të posaçme Ligjin nr 18/2017 *“Për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve”*, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, VKM 499 datë 29.08.2018 *“Për miratimin e PSV dhe mbrojtjen e viktimave të mundshme të trafikimit”*.

⁷⁶ VKM Nr. 54, dt. 31.01.2018 *“Për Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijës”*; o VKM Nr. 91, dt. 14.02.2018 *“Për Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”*; VKM Nr.148, datë 13.03.2018 *“Për Përcaktimin e Rregullave të Bashkëpunimit ndërmjet Mekanizmave Këshillimorë e Koordinues Institucionalë, Strukturave për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Organizatave Jofitimprurëse, për Realizimin e Politikave Kombëtare e Vendore si dhe për shërbimet e Nevojshme për Mbrojtjen e Fëmijës”*; VKM Nr. 353, dt. 12.6.2018 *“Për Rregullat e Funksionimit të Grupit Teknik Ndërsektorial për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë bashkive dhe Njësive Administrative”*.

3.4 Mbrojtja e Viktimave të huaja:

3.41 Për viktimat e huaja, Neni 54 i Ligjit 108/2013 “Për të huajt” parashikon mundësinë e lëshimi i lejes së qëndrimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Sipas këtij neni “Autoriteti i përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin pajis me leje të përkohshme qëndrimi të tipit “A”, për një afat 3-mujor, të huajin, pavarësisht nga vullneti i tij/saj për të bashkëpunuar me drejtësinë, kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se i huaji është viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit, e identifikuar si e tillë nga strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit. Gjatë periudhës së rikuperimit dhe reflektimit, viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit gëzojnë të gjitha të drejtat dhe shërbimet që përfitojnë viktimat e trafikimit, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

3.42 Nga raporti zyrtar i Koordinatorit Kombëtar Anti-trafik rezulton se për vitin 2019 është mundësuar kthimi vullnetar i asistuar për 6 VT/VMT të huaja dhe 1 rast për 2020. Kostot e udhëtimit janë mbuluar nga organizatat që kanë identifikuar rastet.

3.43 Nuk ka raste të raportuara gjatë 2019 në lidhje me numrin e viktimave të huaja të cilat janë kthyer jovullnetarisht ose të detyruara nga vendi që monitoron në vendin e tyre të origjinës. Po kështu nuk ka të dhëna të raportuara për 2019 në lidhje me rastet e viktimave të huaja të trafikuar, kthimi i të cilave në vendin e tyre të origjinës të jetë vonuar për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të zyrtarëve të shtetit të tyre të origjinës. Asnjë rast nuk është raportuar nga viktimat e huaja të cilat të jenë ankumuar si jo të sigurta në vendin ku janë strehuar. Nuk ka asnjë rast që një viktime trafikimi t'i jetë refuzuar leja e qëndrimit.

3.34 Në një rast të ndjekur nga Qendra “Të Ndryshëm dhe të barabartë”, edhe pse të referuar që nga 2017, institucionet kanë qenë bashkëpunuese në mbrojtjen e viktimave të huaja. Në rastin e shtetases rumune M.P, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit është treguar bashkëpunuese në pajisjen e M. me leje qëndrimi dhe rinovimin e vazhdueshëm të saj; Shërbimi Kombëtar i Punësimit nëpërmjet Zyrës së Migracionit ka lehtësuar në procedurat për pajisjen e M me leje pune në Shqipëri dhe përgjigja ka ardhur në kohë shumë të shkurtër (5 ditë nga aplikimi); Ambasada Rumune në Republikën e Shqipërisë ka ndihmuar M në pajisjen me pasaportë 1 vjeçare dhe në bashkëpunim me autoritetet rumune po lehtëson procedurën në pajisjen me pasaportë 10 vjeçare.

Rekomandime në lidhje me grupin e indikatorëve C

-Nevoja për riformulimin e Nenit 52/a të KPrP për të mundësuar përfitimin për VT/VMT nga ulja e dënimit ose përjashtimi nga dënimi edhe në mungesë të kallëzimit apo bashkëpunimin me organet e drejtësisë

-Nevojitet trajtimi i barabartë i VT/VMT në lidhje me mbrotjen e të drejtave ligjore të ofruara

-Nevoja për amendime në ligjin “Për kujdesin shëndetësor në RSH” me qëllim mundësimin e mbulimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor edhe për VMT.

-Ndërmarrja e masave të posaçme për mbrojtjen e VT/VMT nga hakmarrja apo kërcënimet e trafikantëve gjatë procesit të hetimit/gjykimit

-Rritja e bashkëpunimit të Autoritetit Përgjegjës me organet konsullore në lidhje me kthimin e asistuar të VT/VMT;

-Rishikimi i indikatorëve/treguesve në lidhje me mbrotjen e fëmijëve – VT/VMT duke pasuruar në to: nr e fëmijëve dëshmitarë, nr e fëmijëve që janë intervistuar, nr e fëmijëve të dyshuar si VF, gjinia e fëmijëve VT/VMT, mosha e fëmijëve VT/VMT, forma e shfrytëzimit të fëmijëve VT/VMT.

4 ASISTENCA DHE MBËSHTJETJA PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT: GJETJE TË SHQIPTAR PËR 2019

4.1 Asistenca në përgjithësi për viktimat e trafikimit

4.1 Kuadri ligjor shqiptar ofron përmes legjislacionit procedural penal dhe ligjeve të veçanta të drejta të përcaktuara qartë në lidhje me VT/VMT. Mbështetja/asistenca e tyre mbulohet kryesisht me fondet e Buxhetit të Shtetit. Për vitin 2019 u lëvrua fondi prej 28.320.466 milionë lekësh nga buxheti i shtetit, për pagesat e 29 punonjësve socialë që ofrojnë shërbime në qendra rezidenciale dhe për fond ushqimesh për rastet e trafikuar në Qarkun e Vlorës, Tiranës dhe të Elbasanit, nëpërmjet subjekteve jopublike, Shoqatës “Tjetër Vizion” “Vatra”, dhe “Të ndryshëm të barabartë”. Specifikisht:

- | | |
|--|---|
| 1. Organizata “Të ndryshën dhe të barabartë” | 2.306.800 lekë fond ushqimesh |
| | 6.747.687 lekë fond pagash (9 punonjës) |
| 2. Organizata “Tjetër Vizion” – | 2.190.000 lekë fond ushqimesh |
| | 5.792.615 lekë fond pagash (8 punonjës) |
| 3. Qendra “Vatra” | 2.307.800 lekë fond ushqimesh |
| | 8.976.564 lekë fond pagash (12 punonjës) |

Me rëndësi për t’u përmenduar, është fakti se me financimin e Ambasadës Britanike, nga Janar 2020 e në vazhdim, tre strehëzat antitrafik janë duke ofruar ndihmë financiare edhe në distancë. Kjo ndërhyrje është realizuar përmes planeve individuale të hartuara mbi bazën e vlerësimit të nevojave. Viktimave u jepet ndihma sipas rasteve në familje ose në apartamentet me qera.

4.2 Për të gjitha VT/VMT të identifikuar dhe të referuara për shërbime gjatë 2019-‘20 është ofruar një paketë e plotë shërbimesh nga strehëzat e KKSAT në bashkëpunim edhe me institucione të tjera si edhe bazuar në vlerësimin e nevojave. Sipas standardeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e trafikimit, për çdo rast duhet të bëhet vlerësimi i nevojave imediate sapo rasti hyn në qendër dhe brenda dy javëve duhet të bëhet vlerësimi i nevojave të përgjithshme të rastit dhe fëmijës (në rast se viktimë shoqërohet me fëmijë). Sipas raportit të DASH, gjatë 2019 qendrat e KKSAT dhe qeveria mbështetën në shërbime 115 VT/VMT përfshirë ushqimin, asistencë psiko-sociale, këshillim ligjor, kujdes shëndetësor, shërbime të edukimit, shërbime të punësimit, mbështetje të fëmijëve të viktimave, mbështetje financiare, akomodim afatgjatë, aktivitete sociale, trajnim profesional etj.⁷⁷

4.3 Specifikisht, gjatë 2019 kanë marrë paketën e plotë të shërbimeve si më poshte:

- 55 VT/VMT janë pajisur me karta shëndeti;
- 57 VT/VMT janë strehuar në apartamente me qera;
- 89 VT/VMT janë rregjistruar në shkollë dhe kanë ndjekur mësimin;
- 52 VT/VMT kanë marrë formimin profesional;

⁷⁷ Raport për trafikimin e personave, 2020, DASH, fq 69.

- 54 VT/VMT janë punësuar me ndërmjetësimin e 3 qendrat jo publike që ofrojnë shërbime për VT/VMT.

4.4 Ndërkohe nuk ka të dhëna gjatë 2019 për viktimat të cilat të kenë raportuar që nuk kanë strehim të sigurt dhe të përshtatshëm. Të gjitha rastet e identifikuar nga KKSAT janë strehuar në strehëza, apartamente me qera ose pranë familjeve të tyre. Në disa raste, fëmijët e mitur, janë strehuar pranë institucioneve të përkujdesit rezidencial nën varësinë e Shërbimit Social Shtetëror.

4.5 Po kështu nga të dhënat e marra nga strehëzët që ofrojnë shërbime për VT/VMT rezulton se ka pasur raste kur viktimave iu është ofruar strehim alternativ për shkak të nevojave specifike të tyre si për shembull rastet kur VT/VMT referohen në qendra të tjera për shkak të moshës, problemeve të sigurisë etj. Gjithashtu, rastet që kanë kaluar fazën e krizës janë dërguar në strehëza alternative si apartamente të mbështetura me qera nga organizatat apo bashkia. Janë raportuar po ashtu edhe raste të minorenëve me probleme të shëndetit mendor të cilët janë strehuar në struktura strehimi më të përshtatshme në përputhje me nevojat specifike të tyre.

4.6 Referuar asistencës të përshtatshme materiale për viktimat e trafikimit, edhe pse gjatë periudhës së raportimit nuk ka të dhëna zyrtare që tregojnë raste të mungesës së ofrimit të mbështetjes financiare për VT/VMT, OJF kanë evidentuar si problematikë numrin e ulët të VT/VMT të identifikuar gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport (sidomos 2020). Si rezultat i numrit të ulët të viktimave të identifikuar, mund të ketë VT/VMT të cilave nuk iu është ofruar asistencë adekuade për shkak të mos-identifikimit të tyre nga autoritetet përgjegjëse.

4.7 Ndërkohë, në lidhje ndihmën mjekësore të viktimave të trafikimit, vlen të përmendet se referuar kuadrit ligjor në fuqi, të gjitha VT/VMT e përfitojnë shërbimin shëndetësor falas dhe duhet të pajisen me kartën e shëndetit. Megjithatë gjatë 2019, vetëm 55/103 viktimat kanë marrë këtë shërbim. Po kështu, problem i identifikuar nga KKSAT mbetet mundësia e ofrimit të shërbimit spitalor apo edhe komunitar për VT/VMT që kanë crregullime të problemit mendor, sidomos në rastet e viktimave që ndodhen në situata më të rënduara për shkak të psikozave të ndryshme që ato kanë. Brenda kësaj kategorie viktimash, ka pasur edhe raste kur viktimat që sipas ligjit janë të detyruara të marrin shërbim spitalor të kenë shprehur rezistencë apo nuk kanë pranuar ta marrin këtë shërbim.

4.2 Asistenca dhe mbështetje për fëmijët viktimë

4.21 Gjatë periudhës 2019-2020 të mbuluar nga ky raport, fëmijët e identifikuar si VT/VMT zënë pothuajse 65% të numrit total të viktimave (67/2019 dhe 56/2020). Fëmijët e identifikuar si VT/VMT kërkojnë një angazhim akoma më të madh nga ana e shtetit shqiptar nisur nga statusi me vulnerabël që ata kanë brenda kuadrit të VT/VMT. Nga momenti i identifikimit koha mesatare që një fëmijë e supozuar VT të marrë strehim dhe ndihma të tjera është 1-2 ditë. Fëmijët e identifikuar si viktimat strehohen dhe marrin ndihmë financiare në qendrat e specializuara antitrafik. Ndihmë përfitojnë të gjithë fëmijët e strehuar në strehëza. Në momentin e daljes nga shërbimi ndihma vazhdon duke e adresuar për shërbime shtetërore falas nga PMF. Në të gjitha qendrat, shërbimi për këtë kategori ofrohet i përshtatshëm për moshën.

4.22 Në këtë aspekt si qendër e specializuar për të miturit është vetëm “Tjetër Vizion”, e cila për gjatë periudhës së monitorimit ka ofruar shërbim për 23 fëmijë VT&VMT gjatë 2019 dhe 19 fëmijë gjatë 2020. Të gjithë fëmijët kanë marrë shërbime të këshillimit psiko-social të përshtatshëm për moshën e tyre nga kjo qendër. Pjesa tjetër e fëmijëve, 44 për 2019 dhe 37

për 2020, janë asistuar nga Qendra “Të ndryshëm dhe të Barabartë” dhe qendra psiko sociale “Vatra”.

4.23 Mungojnë gjatë kësaj periudhë të dhënat statistikore për vendosjen e fëmijëve viktimë në familje kujdestare. Në të njëjtën kohë, nuk ka të dhëna që fëmijë viktimë të jenë vendosur në qendra të paspecializuara.

4.24 Fëmijët e kategorizuar si VMT dhe VT kanë marrë shërbimin e duhur mjekësor pasi në momentin e kategorizimit ato referohen dhe marrin shërbime në strehëzat antitrafik. Pothuajse mbi 80 % e fëmijëve të identifikuar gjatë 2019 dhe gjatë 2020 si VMT nga të gjitha njësitë lëvizëse ishin në moshë shkollë, por e frekuentonin atë me mungesa, ose nuk e frekuentonin fare. Fëmijët e identifikuar referohen për shërbime në strehëza ose marrin shërbime në distancë sipas nivelit të rrishtit. Të gjithë fëmijët e identifikuar si VMT gjatë 2019 dhe 2020 pas referimeve i janë rikthyer shkollës. Fëmijët që ishin mbi moshën 16 vjeç u regjistruan dhe ndoqën kurset profesionale (7 në total nga të cilët 6 janë strehuar dhe marrin shërbime pranë Tjetër Vizion dhe 1 rast është duke iu ofruar shërbimi në familje).

4.25 VT/VMT të mitur gëzojnë përveç të drejtave të përgjithshme për cdo VT/VMT gjithashtu të drejtën :

a) të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;

b) të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;

c) të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.

4.3 Ndhimë juridike falas dhe asistencë ligjore

4.31 Viktimat e dhunës dhe trafikimit janë një kategori vulnerabël për të cilën ligji parashikon mbrojtje të veçantë duke garantuar mos cënimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social ose ekonomik të tyre.

4.32 Në vitin 2017, Ministria e Drejtësisë ndërmori iniciativën ligjore për të bërë disa ndryshime në ligjin organik që rregullon sistemin e ndihmës juridike falas. Ligji ekzistues nr.10039/2008, u shfuqizua duke passjellë hyrjen në fuqi të ligjit nr.111/2017, i cili solli një sistem të ri të ndihmës juridike falas.

4.33 VT/VMT kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë juridike falas në formën e ndihmës juridike parësore, ndihmës juridike dytësore, si dhe nëpërmjet përjashtimit nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas ligjit, dhe përjashtim nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit. Miratimi i këtij ligji është konsideruar si një arritje në kuadër të garantimit të mbrojtjes për VT/VMT.

4.34 Me synim forcimin e aksesit në drejtësi përmes ligjit për Ndhimë Juridike, Ministria e Drejtësisë gjatë 2019-2020 përgatiti aktet nënligjore me qëllim zbatimin e këtij ligji, **duke i dhënë një rëndësi të veçantë pikërisht ofrimit të ndihmës juridike falas për gratë të cilat janë viktimë të dhunës në familje dhe trafikimit.** Nga 2018, në cilësinë e kategorive të veçanta, pavarësisht të ardhurave apo pasurive të tyre, do të përfitojnë edhe: *viktimat e dhunës në familje; viktimat e abuzuar seksualisht apo trafikimit të qënieve njerëzore apo viktimat e mitur.*

4.35 Sipas Ligjit 111/2017 viktimat e trafikimit mund të përfitojnë :

1. Ndihmë juridike parësore, e cila konsiston si vijon:

- Informacion në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
- Këshillim ligjor;
- Këshillim mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
- Ndihmë në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
- Përfaqësim përpara organeve administrative;
- Dhënien e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

2. Ndihmë juridike dytësore, e cila konsiston si vijon:

- Përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën;
- Ofrimin e këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.

4.36 Me rëndësi për t'u përmendur është gjithashtu përfundimi i procesit të autorizimit nga Ministria e Drejtësisë për klinikat e ligjit dhe OJF që mund të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike falas. Gjatë 2020 janë ngritur nga kjo Ministri me asistencën e PNUD tetë qendra të ofrimit të ndihmës juridike në Lushnjë, Durrës, Tiranë, Pogradec, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë dhe janë autorizuar 12 organizata jofitimprurëse për të ofruar këtë shërbim.

4.37 OJF e autorizuar Qendra të Ndryshëm dhe të Barabartë është organizata e vetme e cila merret kryesisht me mbrojtjen e viktimave të mundshme të trafikimit dhe ka raportuar në baza mujore raste të lidhura specifikisht me viktimat e trafikimit (Konkretisht për periudhën Shtator-Nëntor 2020 janë trajtuar **31 raste nga kjo OJF** dhe 2 raste nga 2 OJF të tjera)

4.37 Ndërkohë që, Drejtoria e Ndihmës Juridike falas ka lidhur gjithashtu marrëveshje bashkëpunimi me 10 klinika të Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë.

4.38 Gjithashtu, me rëndësi është parashikimi në ligj i mundësisë për viktimat që kanë përfituar nga ndihma juridike dytësore që të mund të përfitojnë përjashtim nga:

- *Pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit);*
- *Parapagimi i tarifës së ekzekutimit të vendimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.*

4.39 Në aspektin statistikor mund të themi se, nga të dhënat statistikore që disponon Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, rezulton se gjatë vitit 2019 nuk ka pasur asnjë VT/VMT që ka përfituar ndihmë juridike falas parësore apo dytësore. Ndërkohë që nga të dhënat e vitit 2020 rezulton se 33 raste të VT/VMT kanë përfituar ndihmë juridike parësore falas nga OJF e autorizuar nga MD për këtë qëllim . Ndërkohë që nga 146 çështje të regjistruara pranë kësaj

drejtorie në lidhje me përfitimin nga ndihma juridike dytësore, asnjë rast nuk i përket VT/VMT.

4.5 Kompensimi i viktimave të trafikimit, raste praktike

4.51 Dëmshpërblimi i viktimave të trafikimit është një ndër të drejtat e parashikuara në legjislacionin civil dhe penal dhe mund të kërkohej në gjykatën civile dhe penale kundrejt autorit të veprës penale (Neni 61 “Padia civile në procesin penal”, Kodi i Procedurës Penale, nenet 640 e vijues të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë).

4.52 Shteti Shqiptar nuk ka krijuar një fond të përgjithshëm kompensimi për të paguar kompensimin për viktimat e krimit, në të cilin viktimat e trafikimit mund të kenë qasje pas dënimit të personit të akuzuar për trafikim, pavarësisht nëse viktimat ka vendbanim në vend.

4.53 Gjithashtu, shteti shqiptar nuk ka ngritur asnjë fond specifik kompensimi për të bërë pagesa për viktimat e trafikimit, pavarësisht nëse personi i dyshuar për trafikim është ndjekur penalisht apo dënuar. Legjislacioni ka parashikuar që viktimat të kërkojnë të dëmshpërblehen në procesin penal ku po gjykohej i pandehuri nëpërmjet padisë civile në procesin penal.

4.54 Nga praktika ka rezultuar se janë shumë të pakta rastet kur viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore e kërkojnë këtë të drejtë nëpërmjet procesit gjyqësor civil apo dhe penal. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) ka eksperiencë shumë të gjatë për të bërë të mundur edukimin e viktimave dhe garantimin e kësaj të drejtë. Kështu, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale, avokatet e QNL kanë përfaqësuar çështjen e viktimës së trafikimit V.P. Viktima e trafikimit V.P. është këshilluar në lidhje me të drejtat e saj për tu dëmshpërblyer që gjatë fazës së ndjekjes penale të të akuzuarit për kryerjen e veprës penale trafikim i personave në bashkëpunim. Ajo nuk e ka ushtruar këtë të drejtë në këtë fazë procedurale por në përfundim të gjithë procesit, pasi i pandehuri (trafikanti) është dënuar me vendim të formës së prerë. Në këto kushte QNL i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ka kërkuar **dëmin pasuror dhe jo pasuror**, si dhe përjashtimin nga të gjitha shpenzimet e procesit gjyqësor përfshirë (pagesën për tarifat mbi aktet dhe ekspertët).

4.55 Viktima e trafikimit, si dhe çdo viktimë trafiki bazuar në nenin 608 të Kodit Civil legjitimohet që të kërkojë dëmin moral dhe material që ka shkaktuar trafikanti. Në këtë rast, QNL ka kërkuar nga Gjykata pranimin e kërkesë padisë dhe detyrimin e trafikantit të dëmshpërblejë si viktime e trafikimit në vlerën maksimale 6.640.992,6 lekë të përcaktuar nga eksperti mjekoligjor. Gjykata vendosi pranimin e kërtimeve të viktimës së trafikimit duke e dëmshpërblyer atë për dëmin pasuror dhe jo pasuror.

Problematika të evidentuara gjatë procesit gjyqësor civil të V.P të ndjekur nga QNL

4.56 Një ndër problematikat kryesore që qendra hasur në proceset e kërimit të dëmit (përpara ndryshimeve që pësoi i gjithë legjislacioni si pasojë e reformës në drejtësi) është garantimi i aksesit në sistemin e drejtësisë.

4.57 E drejta për tu përfaqësuar nëpërmjet një avokati. Aktualisht nuk ka avokatë të cilën kanë specializimin e duhur për të ofruar shërbime ligjore falas të cilët/cilat do të përfaqësojnë viktimën në të gjitha proceset gjyqësore dhe jo gjyqësore. Kryesisht, avokatët e organizatave jo-fitimprurëse janë të vetmit profesionistë të cilët kanë ekspertizën e duhur për të punuar me viktimat e trafikimit konform standardeve. Zbatimi i ligjit të ri për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, i cili kërkon dhe trajnimin fillestar dhe të vazhdueshme të avokatëve do ta përmirësojë këtë problematikë.

4.58 Përfashtimi nga tarifat dhe shpenzimet për ekspertet. Në procesin e mësipërm gjykata nuk mori asnjë vendim të ndërmjetëm për ta përjashtuar viktimën nga pagesa e aktit apo nga shpenzimet e ekspertëve psikologë dhe mjeko-ligjorë, ai kërkoi më tepër ndihmën e ekspertëve që këtë rast ta realizonin pa pagesë. Gjithashtu, mendojmë se ligji i ri i ndihmës juridike të garantuar nga shteti ka parashikuar përjashtimin nga shpenzimet e eksperteve dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) ka një fond të posaçëm për këtë. Gjatë procesit u vu re se ekspertët e thirrur nga Gjykata kryesisht eksperti psikolog nuk kishte edukimin, trajnimet e nevojshme për të bërë një raport për një viktme trafikimi dhe shpesh herë gjatë intervistave të realizuar e ka ri viktimizuar atë. Meqenëse ligji i ri ndihmës juridike të garantuar nga shteti ka parashikuar një procedurë të mire përcaktuar dhe një vendimmarrje nga gjykata me qëllim përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet për ekspertet, mendojmë që për viktimat që do të kërkojnë kompensimin ky parashikim ligjor do të jetë më efektiv. Gjithashtu, viktimat ka të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës për përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet për ekspertet.

4.58 Një problematikë tjetër e evidentuar në këto procese është edhe çështja e të provuarit, duke qenë se barrën e provës e ka paditësi (viktimat). Kryesisht është evidentuar mos bashkëpunim dhe mos kthim përgjigjesh nga institucionet shtetërore për të vërtetuar dëmin shëndetësor. Edhe pas një sërë shkresash drejtuar mjekëve dhe laboratorëve ku viktimat kryente kontrole dhe vizita të vazhdueshme nuk patën asnjë përgjigje. Gjithsesi në këto raste, vendimi penal i formës së prerë, raportet e ekspertëve janë prova të mjaftueshme për gjykatën për të disponuar me një vendimmarrje në favor të viktimës së trafikimit.

Çështja e trafikimit, ekzekutimi i vendimit të formës së prerë

4.59 Rasti i dytë që do të trajtohet lidhet me përpjekjet për të bërë të mundur ekzekutimin e një vendimi civil të formës së prerë i cili ka dëmshpërblyer një viktimë trafikimi, D.S. Avokatet e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare kanë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimit duke iu drejtuar Zyrës Shtetërore të Përmbarrimit, një zyre private përmbarrimi, Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

4.60 Me anë të Vendimit nr., datë 19.02.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur që shtetasi A.A, në cilësinë e autorit të veprës së mësipërme penal, të detyrohet të dëmshpërblejë si viktimë trafikimi në shumën prej 40000 (dyzet mijë) EUR si dëm jopasuror. Ky Vendim është shoqëruar edhe nga Vendimi Urdhër Ekzekutimi.

Në bazë të këtij Vendimi, si dhe mbështetur në nenin 11 e në vijim të Ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, institucioni i ngarkuar për ekzekutim është Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara. Ky institucion e ka kryer konfiskimin e pasurisë së shtetasit A.A që në vitin 2009, e për rrjedhojë, ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në favorin e viktimës D.S nuk është arritur të kryhet deri më sot.

4.61 Bazuar në ligjin nr.70/2017, datë 27.04.2017, i cili ka ndryshuar Ligjin nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, kategoria e personave që legjitimohen të përfitojnë dëmshpërblim nga Fondi i i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit përfshin dhe viktimat e krimit të organizuar dhe të trafikimit, në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor.

Neni 37/2 (ç) i këtij ligji parashikon si më poshtë:

“2. Ky fond shërben për:

ç) dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor”

4.62 Në bazë të këtij Ligji, si dhe Vendimit Urdhër Ekzekutimi, QNL ka kërkuar nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e ekzekutimit të vendimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt dëmshpërblimin tim moral dhe material, si viktimë trafiku. Kjo agjenci është përgjigjur negativisht ndaj këtij kërkesi duke pretenduar se nuk kanë asnjë tagër për ekzekutimin e vendimeve që lidhen me dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit.

4.63 Bazuar në ligjin Nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” është përcaktuar një mënyrë e re dhe procedurë e re që do të bëjë të mundur edhe ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë. Qëllimi i këtij ligji është miradministrimi dhe përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.

4.64 Ky ligj përcakton rregullat, procedurat dhe strukturën administrative për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet e drejtësisë apo me urdhra administrativë, sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar në fuqi.

4.65 Ligji do të zbatohet për: pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës kompetente, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit; pasuritë, për të cilat është vendosur masa e sekuestrimit preventiv, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, dhe ato të konfiskuara me vendim të gjykatës kompetente, sipas dispozitave të Kodit Penal, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to.

4.66 Për sa më sipër, problem i konstatuar gjatë ndjekjes së këtyre rasteve lidhet me ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të Gjykatave në lidhje me dëmshpërblimin e VT, problem ky që vinte si pasojë e mosveprimit të Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara.

Rekomandime në lidhje me grupin e indikatorëve D dhe E:

- Trajnimi i avokatëve dhe ekspertëve me qëllim specializimin e tyre në trajtimin e VT/VMT për të shmangur ri-viktimizimin e tyre
- Krijimi i një fondi të përgjithshëm kompensimi për të paguar kompensimin për viktimat e krimit, në të cilin viktimat e trafikimit mund të kenë qasje pas dënimit të personit të akuzuar për trafikim, pavarësisht nëse viktimat ka vendbanim në vend.
- Ngritja e një fondi specifik kompensimi për të bërë pagesa për viktimat e trafikimit, pavarësisht nëse personi i dyshuar për trafikim është ndjekur penalisht apo dënuar si dhe krijimi i një skeme shtetërore kompensimi për viktimat e trafikimit .
- Zbatimi i masës së përjashtimit nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore për VT/VMT
- Marrja e masave për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë për kompensimin e VT/VMT
- Monitorimi i procesit të kompensimit të viktimave të trafikimit dhe krijimi i një sistemi të dhënash në lidhje me numrin e kërkesave për kompensim dhe rezultatet e tyre.
- Vlerësimi i situatës paraprake nga ana e policisë së shtetit dhe shërbimit social për gra dhe vajza që shfryrëzohen në prostitucion dhe dhënia e mundësisë për rehabilitim dhe ri-integrim, me qëllim parandalimin e dënimit të viktimave së bashku me trafikantët.
- Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale për të përfshirë në kompetencën e SPAK të gjitha çështjet e TQNJ, si dhe për të garantuar kompensimin e viktimës
- Krijimi i një sistemi të unifikuar të dhënash mbi çështje penale të trafikimit

5 KUADRI INSTITUCIONAL, DUKE PËRFSHIRË KAPACITETET, KOORDINIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR.

Kuadri institucional, bashkëpunimi dhe koordinimi kombëtar dhe ndërkombëtar

5.1 Kuadri institucional në fushën e politikave antitrafik drejtohet nga Koordinatori Kombëtar Antitrafik, pozicionin e të cilit e ushtron Zv. Ministri i Brendshëm. Po kështu në Ministrinë e Brendshme është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Antitrafikut dhe Azilit si strukturë e posaçme që ushton kompetenca në zbatimin dhe monitorimin e politikave anti trafik në Shqipëri. Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikimit të Personave është ngritur dhe funksionon në përputhje me Vendimin Nr.8 datë 5.1.2002 “Për krijimin e Komitetit Shtetëror të luftes kundër trafikut të qenieve njerëzore. Komiteti Shtetëror për Luftën Kundër Trafikimit të Personave ka përgjegjësinë e përgjithshme për reagimin ndaj trafikimit, nëpërmjet Task Forcës Kombëtare për Trafikimin e Personave (përfshirë të gjitha palët e interesuara shtetërore ose joshetërore në lidhje me antitrafikimin), nën bashkërendimin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik. Në nivel vendor, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.6 date 26.01.2017 janë ngritur dhe funksionojnë komitetet Rajonale të luftës kundër trafikimit të personave në cdo qark.

5.2 Ndërkohë, Autoriteti përgjegjës në këtë fushë është struktura e ngritur me udhëzimin e përbashkët nr. 3799, datë 8.7.2014 “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”, që përbëhet nga përfaqësues të ministrive nënshkruese, si dhe një përfaqësues i Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik. Autoriteti Përgjegjës është struktura thelbësore që vë në lëvizje Mekanizmin Kombëtar të Referimit për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

5.3 Në nivel të strukturave specifike, Zyra e Koordinatorit Kombëtar ka si detyrë kryesore koordinimin e përpjekjeve antitrafik në shkallë vendi e më gjerë në drejtim të 4 shtyllave kryesore: Parandalimit, mbrojtjes dhe asistencës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, ndjekjes penale të trafikantëve dhe personave të përfshirë në të, si edhe partneritetit si ndërmjet institucioneve shtetërore, atyre shtetërore të pavarura, si edhe organizatave vendase dhe ndërkombëtare, partnere dhe aktive në përpjekjet antitrafik. Në nivel të hetimit dhe ndjekjes penale, policia e Shtetit ka struktura të specializuara antitrafik. Megjithatë, buxheti i këtyre strukturave nuk funksionon si një zë më vete në buxhetin e policisë së shtetit.

5.4 Gjithashtu, vendimi Nr. 499 datë 29.8.2018 “Për miratimin e PSV-ve për mbrojtjen e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit” përcakton qartësisht institucionet përgjegjëse që janë të përfshira në procesin e identifikimit dhe mbrojtjes së VT/VMT. Sipas kësaj VKM, agjencia/institucioni përgjegjës për identifikimin formal është grupi/struktura përgjegjëse për identifikimin formal në kufijtë dhe territorin e Republikës së Shqipërisë, i ngritur ad-hoc që kryen intervistimin formal të personave që identifikohen si viktima të mundshme të trafikimit, e përbërë nga një punonjës i policisë së shtetit i seksionit të luftës kundër trafikeve të paligjshme (SLKTP) dhe punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve/NJMF në

bashki/njësi administrative për çdo rast të të miturve dhe një punonjës social shtetëror i zyrës rajonale të shërbimit social shtetëror (ZRSHTSH) për të rriturit.

5.5 Anëtarët e Mekanizmit Kombëtar të Referimit mblidhen 4 herë në vit. Gjatë 2019 janë zhvilluar 4 takime të MKR në të cilat është diskutuar në lidhje me problematikat e hasura dhe angazhimin institucional të secilit anëtar të MKR në mënyrë të koordinuar për të rritur përpjekjet dhe rezultatet në fushën e politikave anti-trafikim mbi identifikimin dhe referimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit dhe zbatimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e VT/VMT. Në cdo mbledhje marrin pjesë 13 pjesëmarrës të përhershëm të MKR dhe 3-4 institucione ndërkombëtare të ftuara.

5.6 Një rol të rëndësishëm në funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit luajnë organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime në fushën e parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe mbrojtjes së VT/VMT. Aktualisht janë 8 organizata që marrin pjesë në MKR. Megjithatë, numri i OJF që bëjnë kërkesë për t'iu bashkuar MKR vjen gjithmonë në rritje. Vetëm gjatë 2019, tre organizata të reja Caritas, CRCA dhe NISMA kanë bërë kërkesë për t'u anëtarësuar pranë këtij mekanizmi. Kjo tregon për një përfshirje të lartë të OJF në MKR (8 nga 13 anëtarë deri 2019). Nga të gjitha organizatat e përfshira, tre prej tyre kanë rol formal dhe përgjegjësi në sistemin kombëtar kundër trafikimit dhe për mbështetjen e viktimave : “Të ndryshëm dhe Të barabartë”, qendra Psiko-Sociale “Vatra” dhe organizata “Tjetër Vizion”.

5.7 Në lidhje me identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të mitur, gjatë periudhës së raportimit janë ngritur pesë dhoma të intervistimit për të miturit në Komisariatit Nr.5 në Tiranë, në Kamëz, Lezhë, Kurbin dhe Korçë. Dy nga këto dhoma janë ngritur gjatë 2019 nga NISMA-ARSIS dhe një dhomë është ngritur gjatë 2020 nga UNICEF me mbështetjen e Ambasadës Britanike. Sipas Urdhërit nr 413 datë 05.04.2019 të Drejtorit të Policisë së Shtetit, procedurat standarde të veprimit të strukturave për identifikimin, mbrojtjen dhe referimin e VMT duhet të zbatohen në të gjitha drejtoritë vendore të policisë. Në zbatim të këtij urdhëri, të gjithë oficerët e policisë gjyqësore të cilët hetojnë trafikimin e personave në nivel qendror e lokal duhet të marrin pjesë në trajnime të specializuara për këtë qëllim. Nga të dhënat e mbledhura nga organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë” vetëm gjatë 2019 janë zhvilluar 32 trajnime nga strukturat e policisë në të gjithë vendin me pjesëmarrjen e 2036 punonjësve të policisë.

5.8 Trajnime të specializuara janë kryer edhe për strukturat e Hetimit të Trafikeve të Paligjshme në DVP dhe Prokuroria për Krimet e Rënda. Gjatë 2019 janë trajnuar 132 punonjës të këtyre strukturave në lidhje me “Përmirësimin e zbatimit të MKR-ve për identifikimin dhe referimin e VT/VMT dhe Procedurat standarde të Veprimit” dhe “Hetimet proaktive si trend i trafikimin të qënieve njerëzore”.

5.9 Nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin janë trajnuar në total 41 punonjës për çështjet kundër trafikimit të qënieve njerëzore nga të cilët 23 punonjës janë trajnuar nga FRONTEX dhe Akademia e Sigurisë mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe 18

punonjës të tjerë janë trajnuar nga IOM në lidhje me identifikimin e grupeve vulnerabël në flukset migratore mikse.

5.10 Në të njëjtën periudhë, Shkolla e Magjistraturës ka organizuar disa aktivitete trajnuese në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore, ndjekjen dhe gjykimin e veprave penale të trafikimit të qënieve njerëzore dhe ndryshimet ligjore në këtë fushë, në të cilat kanë marrë pjesë 24 prokurorë.

5.11 Po kështu, ZKKA në bashkëpunim me Prokurorinë e Tiranës, Gjykatën për Krimet e Rënda dhe Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Tiranës kanë trajnuar gjatë kësaj periudhë mbi 31 punonjës në lidhje me hetimet për krimet lidhur me migracionin dhe qasjet multidisiplinare të orientura drejt viktimave.

5.12 Përveç organeve dhe strukturave shtetërore, trajnime të specializuara janë kryer edhe nga organizatat e shoqërisë civile që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e politikave anti-trafik. Kështu gjatë 2019, organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë” ka trajnuar 194 punonjës të agjencive të zbatimit të ligjit në qarqet Tiranë, Fier, Elbasan, Dibër, Kukës dhe Korçë në lidhje me kuadrin ligjor kundër trafikimit dhe ndryshimet ligjore të miratuara si pjesë e reformës në drejtësi.

5.13 Trajnime janë kryer edhe për kategorinë e punonjësve social, psikologëve apo punonjësve të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror që trajtojnë viktimat e trafikimit. Vetëm gjatë 2019 janë trajnuar 109 punonjës nga ZKKA në bashkëpunim me organizatën “Të ndryshëm dhe të Barabartë” dhe 142 punonjës nga ZKKA në bashkëpunim me Qendrën Psiko – Sociale “Vatra”

5.14 Në nivel të marrëveshjeve formale të bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit dhe një ose më shumë institucione shtetërore përkatëse, që kanë informacionin rreth viktimave të trafikimit ose që merren me referimin e viktimave si edhe për funksionimin MKR është hartuar marrëveshja e Bashkëpunimit për Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave (MKR), datë 15.06.2012.

5.15 Ndërkohë në nivel të bashkëpunimit ndërkombëtar, qeveria shqiptare ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimit dhe protokolle shtesë për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore me vendet e tjera si : Ligji nr. 9544, datë 29.05.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Greke, për Mbrojtjen dhe Asistencën për Fëmijët Viktima të Trafikimit”; Protokoll shtesë për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe për përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të ndihmuar të viktimave, apo viktimave të mundshme të trafikimit midis Shqipërisë dhe Malit të Zi në plotësim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Malit të Zi, për bashkëpunim në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikeve të paligjshme dhe aktiviteteve të tjera ilegale (2014) Protokoll shtese per luften kunder trafikimit te personave ndermjet republikës së Shqipërisë dhe Republikës se Kosovës(2012); Memorandumi i Bashkëpunimit midis

Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe "Mbi intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore mbi përmirësimin, njoftimin, referimin dhe kthimin e viktimave të trafikimit" (2014) apo Protokolli shtesë midis Shqipërisë dhe Maqedonisë "Mbi intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore mbi përmirësimin, njoftimin, referimin dhe kthimin e viktimave të trafikimit" (2006)

5.16 Bazuar në marrëveshjet dhe protokollet e siëprcituara, vlen të theksojmë se shteti shqiptar ka rritur kapacitetet e tij në lidhje me kryerjen e hetimeve të përbashkëta të veprave antitrafik në bashkëpunim me shtetet e tjera. Gjatë 2019, sipas raportit të DASH për Shqipërinë, policia e shtetit shqiptar ka arrestuar 12 trafikantë me kërkesë të autoriteteve franceze, gjermane, greke dhe italiane . Po kështu gjatë të njëjtës periudhë qeveria shqiptare ka pritur 4 ekstradime të personave të dyshuar për përfshirje në trafikimin e personave nga Gjermania, Greqia, Italia dhe Holanda. Në të njëjtën kohë, autoritetet shqiptare vazhdojnë hetimet e përbashkëta me autoritetet italiane. Me rëndësi në këtë drejtim mbetet rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim shkëmbimin e informacioneve në lidhje me veprimtarinë kriminale të ushtruar në vendet e destinacionit ku shtetasit shqiptarë janë të dëmtuar apo subjekte të veprës penale. Ky bashkëpunim duhet të konsistojë në inicimin e hetimeve të përbashkëta dhe regjistrimin e procedimeve penale për veprat penale, objekt i punës së strukturave antitrafik.

Rekomandime në lidhje me grupin e indikatorëve F

- Lidhur me mbrojtjen e VT/VMT, ende raportohen shifra të ulëta, çka rithekson nevojën për trajnime në fushën e trafikimit të personave, për të qartësuar rolin dhe funksionin e stafit të shërbimeve shëndetësore, për veprimet dhe mbështetjen që ofrojnë për VT/VMT-të.
- Rritja e bashkëpunimit me SPAK për hetimin e veprave penale dhe ndjekjen e detyrave të deleguara, në lidhje me procedimet penale të regjistruara.
- Forcimi i koordinimit në nivel vendor;
- Rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim shkëmbimin e informacioneve në lidhje me veprimtarinë kriminale të ushtruar në vendet e destinacionit ku shtetasit shqiptarë janë të dëmtuar apo subjekte të veprës penale
- Krijimi i një Reporteri special të pavaruar për drejtimin, koordinimin dhe monitorimin e politikave anti-trafik;
- Forcimi i MKR dhe strukturave përgjegjëse përmes rritjes së kapaciteteve të nëpunësve të specializuar dhe alokimit të fondeve adekuade për funksionimin normal të MKR.

6 MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE JETËS PRIVATE TË VIKTIMAVE/ VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

6.1 Mbrojtja e të dhënave personale dhe jetës private të viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit është një nga të drejtat bazë të VT/VMT që lidhet jo vetëm me mbrojtjen e identitetit të viktimës në vetvete, por gjithashtu edhe me ruajtjen e jetës apo shëndetit të saj nga pasojat e identifikimit. Ekziston një kuadër i gjerë normativ ligjor dhe nënligjor për garantimin e kësaj të drejte në praktikë. Mbrojtja e të dhënave personale dhe jetës private rregullohet si nga ligji nr.9887 datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ashtu edhe nga standardet e parashikuara në VKM nr .499 datë 29.08.2019 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit” dhe udhëzimin nr.316 datë 10.2.2010 të Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale e Shanceve të Barabarta “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”.

6.1 Në këtë kuadër vlen të përmendet fakti se VKM nr.499 e sipërcituar referon si bazë ligjore dhe është hartuar në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale. Procedurat standarde të veprimit parashikojnë gjithashtu edhe detyrimin e përkthyesit për të plotësuar dhe nënshkruar deklartën e konfidencialitetit/ ruajtjes së sekretit në lidhje me të dhënat që përkthyesit marrin dijeni nga VT/VMT për shkak të përkthimit të thënieve të tyre apo dokumentave që përmbajnë të dhënat e tyre.

6.2 Gjithashtu, PSV përcaktojnë edhe të drejtën e VT/VMT për t’u informuar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave të tyre si edhe të drejtën e tyre për të autorizuar ose jo ndarjen e të dhënave të mbledhura me organizatat apo institucionet që ndihmojnë në përputhje me ligjin si dhe ndarjen e të dhënave të pa-personalizuara (që nuk zbulojnë identitetin e viktimave) të mbledhura gjatë intervistës, me strukturat e zbatimit të ligjit me qëllim që të ndihmohen persona të tjerë në nevojë si edhe me qëllimin që të ruhen e të përdoren në përputhje me ligjin, për qëllime të studimeve që kontribuojnë në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Për këtë qëllim, PSV përcaktojnë formatin e lejës së informuar për ndarjen e të dhënave të mbledhura e cila duhet të plotësohet dhe nënshkruhet nga vetë VT/VMT gjatë zhvillimit të intervistës për identifikimin e saj.

6.3 Ndërkohë që udhëzimi nr.316 datë 10.2.2010 të Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale e Shanceve të Barabarta “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi” përcakton si pjesë të standardeve të tij rregullat dhe përgjegjësitë në lidhje me “Të dhënat personale të përfituesit dhe mënyra e menaxhimit të tyre”. Në përputhje me këtë udhëzim, për secilin përfitues (VT/VMT) ofruesi i shërbimit duhet të mbajë një dosje individuale e cila përmban të dhëna personale të VT/VMT të mbledhura nga intervistat/ takimet si edhe cdo dokument tjetër që mund të zbulojë identitetin ose vendndodhjen e VT/VMT, informacion shëndetësor, të dhëna mbi familjen e VT/VMT etj. Të gjitha këto

të dhëna konsiderohen si konfidenciale dhe duhet të administrohen në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë qëllim, cdo strehëz e regjistron përfituesin në bazën e të dhënave me një kod identifikimi të posacëm.

6.4 Në lidhje me viktimat e mitura, mbrojtja e të dhënave dhe jetës private do të duhet të bëhet në përputhje me parashikimet e Kodit Për Drejtësinë Penale për të Miturit, neni 21 “ Mbrojtja e jetës private të të miturit” dhe standardet e parashikuara në VKM nr 499 për miratimin e procedurave standarde të veprimit në rastin e viktimave të mitur.

6.5 Në nivel institucional, në Shqipëri është ngritur dhe funksionon autoriteti kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale të VT/VMT në cilësinë e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në të njëjtën kohë, është ngritur dhe funksionon baza e të dhënave për viktimat e trafikimit SIVET, si pjesë e bazës së të dhënave të integruara në sistemin TIMS, i cili është i vetmi burim zyrtar për statistikën në lidhje me viktimat/ viktimat e mundshme të trafikimit. Gjithashtu, baza e të dhënave të VT/VMT menaxhohet nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim dhe operon në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

6.6 Megjithatë, pavarësisht ekzistencës së kuadrit ligjor në fuqi dhe mundësisë për fillimin e ndjekjes penale në rast të publikimit të informacionit që çon në identifikimin e viktimave të trafikimit nga mediat apo të tjerët, edhe gjatë periudhës që mbulon ky raport vazhdon të ngrihet shqetësim nga qendrat e Koalicionit Antitrafik Kombëtar publikimi në media i rasteve të VT/VMT duke zbuluar figurën dhe / ose identitetin e tyre. Publikimi i këtij informacioni rrit rrezikun për vazhdimin e jetës normale, mbrojtjen e shëndetit dhe jetës dhe integrimin e VT/VMT në shoqëri.

Rekomandime në lidhje me grupin e idikatorëve G

-Nevoja për trajnime të punonjësve socialë, përkthyesve, gazetarëve apo përfaqësuesve të medias në Shqipëri në lidhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale VT/VMT;

-Nevoja për trajnimin e punonjësve të përfshirë në identifikimin formal të VT/VMT në lidhje me të drejtat e VT/VMT për mbrojtjen e të dhënave dhe kuptimin e tyre;

-Marrja e masave për sanksionimin e mediave në rast të publikimit të të dhënave personale të VT/VMT;

-Rritja e rolit të Komisionerit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtës për informim për fillimin kryesisht të procedurave të hetimit dhe ndjekjes së rasteve të cënimit të të drejtave të VT/VMT për shkak të publikimit të të dhënave personale;

-Forcimi i sistemit të të dhënave SIVET dhe ndarja e të dhënave të VT/VMT sipas llojeve dhe formave të shfrytëzimit

Bibliografi:

Akte normative ndërkombëtare:

- Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA
- Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 25 tetorit 2012 Vendosija e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore“, e ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006
- Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, e ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 10 071, datë 09.02.2009
- Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, e ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj”

Akte normative kombëtare

- Kodi i Procedures Penale i RSH, sipas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017
- Kodi Penal i RSH
- Ligji nr. 141/2014, për disa shtesa në ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 37/2017, datë 30.03.2017, “Kodi i Drejtësisë për të Miturit”
- Ligji nr. 9205, datë 15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10 173, datë 22.10.2009 dhe ligjin nr. 32/2017, datë 30.03.2017
- Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar
- Ligj nr.70/2017, datë 27.04.2017, i cili ka ndryshuar Ligjin nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”,
- Ligj Nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”.
- Ligj nr.111/2017”Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti:
- Ligji Nr. 10252, datë 11.03.2010, “ Për disa shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”
- Ligji Nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”
- Ligj “Për mbrojtjen e të dhënave personale”
- ¹Ligj Nr 108/2014 “Për Policinë e shtetit”
- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

- Vendimi nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”
- Vendimi nr. 707, datë 26.08.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 107, datë 10.02.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar
- Vendim Nr. 499, datë 29.8.2018 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”
- VKM Nr. 54, dt. 31.01.2018 “Për Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijës”;
- VKM Nr. 91, dt. 14.02.2018 “Për Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
- VKM Nr.148, datë 13.03.2018 “Për Përcaktimin e Rregullave të Bashkëpunimit ndërmjet Mekanizmave Këshillimorë e Koordinues Institucionalë, Strukturave për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Organizatave Jofitimprurëse, për Realizimin e Politikave Kombëtare e Vendore si dhe për shërbimet e Nevojshme për Mbrojtjen e Fëmijës”;
- VKM Nr. 353, dt. 12.6.2018 “Për Rregullat e Funksionimit të Grupit Teknik Ndërsektorial për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë bashkive dhe Njësi Administrative”.

Raporte:

- Ministria e Brendshme (2019)“Raport vjetor për zbatimin e planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2018-2020;
- United State Department of State. 2020 Trafficking in Persons Report:Albania;
- Qendra “Të ndryshëm dhe të barabartë” (2019) “Raport studimor mbi nevojën e hartimit të një ligji të vecantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit në Shqipëri”.
- Qendra “Të ndryshëm dhe të barabartë “ (2019) “Studim mbi çështjet e bashkëpunimit të viktimave me autoritetet e zbatimit të ligjit.
- Raport Progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020).
- Greta Raport (2020) “ Akses në Drejtësi dhe mjetet efektive për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore”.
- Raport i shtetit shqiptar drejtuar Komitetit CEDAW (2020) për monitorimin e zbatimit të Konventës CEDAW.